



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA
/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT GODIŠNJI IZVEŠTAJ REVIZIJE ANNUAL AUDIT REPORT



Prishtine, Gusht 2015



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA
/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT

**PËR VITIN E PËRFUNDUAR
MË 31 DHJETOR 2014**



TABELA E PËRMBAJTJES

Fjala e auditorit të përgjithshëm	7
1. Hyrje	9
2. Auditimi i jashtëm dhe llogaridhënia.....	10
3. Raporti Vjetor Financiar për Buxhetin e Kosovës.....	12
4. Adresimi i rekomandimeve të dhëna në vitet e mëparshme.....	25
5. Qeverisja e mirë.....	29
6. Prokurim.....	39
7. Sfidat e Institucioneve Buxhetore.....	43
8. Performanca në fushat specifike.....	47
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP.....	53
Shtojca II: Opinionet e auditimit dhe mangësitë menaxheriale.....	55
Shtojca III: Rekomandimet e RVA-së të vitit 2013.....	72



FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Të nderuar anëtarë të Kuvendit,



Kam kënaqësinë që t'ju dorëzoj Raportin Vjetor të Auditimit për vitin financiar 2014. Shpresoj që raporti të jetë i dobishëm për ju, deputetët e legjislacionit të pestë, qeverinë dhe shoqërinë në përgjithësi, në tejkalimin e sfidave të lidhura me buxhetin e limituar dhe ambiciet e integritit në BE.

Ky raport mbulon zbatimin që Qeveria i ka bërë buxhetit 2014 dhe Pasqyrave Vjetore Financiare të Buxhetit të Kosovës për atë periudhë. Ne vazhdimisht i jemi adresuar misionit tonë themelor për ofrimin e bazës që shërben për të kërkuar llogari nga menaxherët shpenzues të parasë publike dhe për dhënien e kontributit për përmirësime në fushën e Menaxhimit të Financave Publike.

Duke pasur parasysh se gjatë vitit 2014 ka ekzistuar një boshllëk në funksionimin e Kuvendit dhe Komisioneve të tij, ne kemi vendosur një fokus të madh në zbatimin e rekomandimeve të vitit të kaluar. Përkundër faktit se është bërë progres gjatë viteve në implementimin e rekomandimeve tona, një numër i konsiderueshëm i tyre vazhdojnë të përsëriten.

Përveç një numri të vogël të institucioneve publike të cilat janë jashtë mandatit tonë të auditimit, ne kemi vazhduar të kryejmë auditimin statutor të rregullsisë për Pasqyrat Vjetore Financiare të të gjithëve, që nga Buxheti i Kosovës deri te entitetet shumë të vogla, si dhe disa fonde të donatorëve. Ne kemi kryer edhe një numër të auditimeve jo-statutore të performancës që kanë të bëjnë me ekonominë, efektivitetin dhe/ose efikasitetin e përdorimit të fondeve publike.

Puna të cilën e kryejmë na ka ofruar njohuri të thella dhe të kuptuarit të entiteteve dhe aktiviteteve të sektorit publik, dhe na ka mundësuar që të japim rekomandime për të promovuar qeverisjen e mirë dhe të përmirësojmë menaxhimin financiar.

Ne vazhdojmë të përmbahemi fuqimisht gjashtë parimeve themelore të cilat i kemi artikuluar, e që janë relevante me auditimin e jashtëm dhe mbikëqyrjen se si janë përdorur fondet publike. Ato janë:

Llogaridhënia – Entitetet publike duhet të japin llogari për performancën e tyre dhe të jenë në gjendje të japin pasqyra të plota dhe të sakta për mënyrën si i kanë shpenzuar fondet publike, përfshirë fondet që u janë dhënë të tjerëve për qëllime të veçanta. Ato duhet të kenë gjithashtu arranzhime të përshtatshme qeverisëse dhe menaxheriale për të mbikëqyrur marrëveshjet për financim.

Çiltërsia – Entitetet publike duhet të jenë transparente në administrimin e fondeve, si për të mbështetur llogaridhënien ashtu edhe për të promovuar qartësi dhe të kuptuarit e përbashkët të roleve dhe detyrimeve përkatëse mes entiteteve dhe çdo pale të jashtme që hyn në marrëveshje financimi. Kjo duhet të mbështetet në marrëveshje të duhura për raportim.

Vlera për para – Entitetet publike duhet ti përdorin burimet në mënyrë efektive dhe ekonomike dhe pa humbje, me kujdesin e duhur për kostot dhe fitimet totale të një marrëveshje dhe kontributit të saj në rezultatet që entiteti mundohet ti arrijë.

Ligjshmëria – Entitetet publike duhet të veprojnë në kuadër të ligjit dhe të përmbushin obligimet e tyre ligjore.

Drejtësia – Entitetet publike kanë të drejtën ligjore për të vepruar drejt dhe në mënyrë të arsyeshme ndaj publikut të gjerë. Ato duhet të jenë, dhe të tregojnë që janë, të paanshëm në vendimmarrjen tyre.

Integriteti – çdokush që menaxhon burimet publike duhet ta bëjë atë me integritetin më të lartë. Standardet që duhen zbatuar janë të qarta dhe entitetet publike duhet ta bëjnë të qartë se ato, që kur financojnë organizata të tjera, presin standarde të ngjashme prej tyre.

Me gjithë progresin e përmendur, ekziston një numër i mangësive të cilat duhet të adresohen. Problemet që kanë lindur për shkak të keq klasifikimit të shpenzimeve kanë kualifikuar opinionin e pasqyrave vjetore financiare të Buxhetit të Kosovës. Ndërsa deficitin buxhetor është mbi kufirin e përcaktuar nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësive.

Kjo bën thirrje për nivel më të lartë të vëmendjes në fazën e planifikimit, që do të lejonte institucioneve të kryejnë veprimtarinë në përputhje me nevojat e tyre dhe të raportojnë në mënyrë të vërtetë dhe të drejtë. Qeveria gjithashtu duhet të jetë e vëmendshme sa i përket kufirit të deficitit buxhetor.

Konsideratë të rëndësishme duhet të ketë në zbatimin e sistemeve dhe mekanizmave të nevojshme të menaxhimit financiar. Për të arritur një ndikim më të madh të fondeve të shpenzuara publike duhet të vendosen sistemet të përmirësuara dhe më të avancuara të raportimit të brendshëm, veçanërisht tek qeverisja lokale.

Duhet të ketë më shumë fokus në maksimizimin e rezultateve dhe arritjen e rezultateve të pasqyruara në vendimmarrje dhe prioritetet politike. Prioritetet e deklaruara duhet të shoqërohen me burimet e nevojshme. Në prodhimin e kursimeve të kërkuara buxhetore, konsideratë duhet të ketë në aplikimin ekonomisë së shkallës, apo adresimin e ndryshimeve të mundshme strukturore.

Ne synojmë të punojmë ngushtë me Kuvendin dhe Qeverinë për ti zhvilluar më tej këto parime si një bazë për reformat aktuale në ndërtimin e qeverisjes së mirë dhe sistemeve më të mira për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Ky raport paraqet sfidat kyçe që duhet të adresohen, të cilat në disa fusha reflektojnë sfida të rëndësishme. Unë e lëvdoj këtë raport para anëtarëve të nderuar dhe pres me padurim diskutimet dhe përgjigjet tuaja.

Prishtine, Gusht 2015



Artan Venhari
Ushtrues detyre i Auditorit të Përgjithshëm

1.HYRJE

Gjatë sezonit 2014/15, ne kemi kryer një gamë auditimesh: 89 auditime statutores të rregullsisë, tetë auditime të fondeve të donatorëve dhe nëntë auditime jo statutores të performancës. Kuvendit i janë dërguar gjithsej 106 raporte . Rekomandimet e dhëna në to janë fokusuar drejt cilësisë më të mirë në raportimin e jashtëm financiar, përmirësimin të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe përmirësimeve të shërbimeve publike.

Qasja jonë e auditimit dhe mbështetja konstruktive ndaj entiteteve të audituara kanë lejuar ndërmarrjen e hershme të veprimeve për adresimin e dobësive dhe zhvillimin e mëtejshëm të qeverisjes së mirë.

Ky raport përmbledh rezultatet e auditimeve tona për vitin 2014 dhe thekson çështjet kyçe dhe temat e përbashkëta që Qeveria, Kuvendi ose Kuvendet Komunale duhet ti trajtojnë në mënyrë aktive. Menaxhimi efektiv për adresimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm është një mekanizëm kyç me të cilin OB-të zhvillojnë aranzhimet e tyre qeverisëse. Në lidhje me këtë, ne kemi vërejtur progres me kalimin e viteve. Qeveria dhe Kuvendet kanë një rol kyç në mbështetjen e këtij procesi.

Ky raport përfshin gjithashtu opinionin e Auditorit të Përgjithshëm në lidhje me Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Kosovës (PVF/BK). Ky auditim ka shqyrtuar rezultatet e auditimeve të OB-ve dhe ndikimin e tyre në pasqyrat e konsoliduara.

Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2013 u dorëzua në Kuvend në fillim të shtatorit. Për shkak të krizës institucionale, ai u diskutua në KMFP në muajin prill dhe u prezantua nga Auditori i Përgjithshëm në seancën plenare në maj 2015. Ne presim që procesi këtë vit të finalizohet përpara se propozimi i Qeverisë për buxhetin 2016 të dorëzohet në Kuvend në fund të tetorit. Për të mbështetur rishikimin efektiv të të gjeturave tona, ne e kemi organizuar raportin si në vijim:

Kapitulli 2 – Auditimi i Jashtëm dhe Llogaridhënia;

Kapitulli 3 - Raporti Vjetor Financiar për Buxhetin e Kosovës;

Kapitulli 4 – Adresimi i rekomandimeve të dhëna në vitet e mëparshme;

Kapitulli 5 – Qeverisja e mirë;

Kapitulli 6 – Prokurimi;

Kapitulli 7 – Sfidat në organizatat buxhetore; dhe

Kapitulli 8 – Performanca në fushat specifike

Raporti gjithashtu i ka edhe tre shtojca. Shtojca e parë shpjegon opinionet e ndryshme të dhëna nga Auditori i Përgjithshëm në auditimin e rregullsisë. E dyta specifikon opinionet e dhëna dhe arsyet për to. Përveç kësaj, në të përmbledhen të gjeturat domethënëse të auditimit në institucionet e audituara. Raportet individuale të auditimit mund të gjenden në faqen tonë të internetit www.oag-rks.org. Shtojca e tretë specifikon mënyrën e adresimit të rekomandimeve të dhëna në Raportin Vjetor të Auditimit 2013.

2. AUDITIMI I JASHTËM DHE LLOGARIDHËNIA

Publiku pret që ata të cilët janë të ngarkuar me menaxhimin e parasë publike të japin llogari për përdorimin e këtyre parave. Përgjegjësia kryesore për sigurimin se paratë publike trajtohen me integritet absolut dhe shpenzohen me maturi u takon Ministrave, deputetëve të zgjedhur të Kuvendit, organeve qeverisëse, menaxherëve dhe zyrtarëve. Auditimi në sektorin publik është një hallkë e rëndësishme e zinxhirit të llogaridhënies. Ai duhet të formojë bazën për një llogaridhënie të forcuar, në drejtim të anëtarëve të zgjedhur të cilët alokojnë burimet, dhe nga jashtë në drejtim të konsumatorëve dhe përfituesve, tatimpaguesve dhe komunitetit më të gjerë në përgjithësi.

Auditimi i jashtëm duhet të shtojë vlerë jo vetëm duke analizuar dhe raportuar atë që ka ndodhur pas ngjarjes, por edhe duke shikuar në të ardhmen, përmes identifikimit të mësimave që duhet mësuar si dhe duke përhapur praktika të mira. Auditimi i jashtëm i sektorit publik në këtë mënyrë ndihmon në promovimin e menaxhimit dhe vendim-marrjes më të mirë dhe si rrjedhojë përdorim më të efektshëm të burimeve të tatimpaguesve, dhe luan një rol të rëndësishëm në rregullimet e qeverisjes korporative të organeve publike. Transparenca dhe qasja publike në informacion është pjesë përbërëse e kësaj.

Auditimi i jashtëm në sektorin publik të Kosovës ofrohet nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) si Institucion Suprem i Auditimit (ISA). Qëllimi ynë kryesor është të ndihmojmë Kuvendin që të kërkojë llogari nga Qeveria dhe institucionet ekzekutive për mënyrën e përdorimit dhe raportimit të parasë publike, duke ruajtur kështu interesat e qytetarit. Puna jonë synon të ndihmojë ata që punojnë në shërbimet publike për të përmirësuar qeverisjen e mirë, performancën dhe ofrimin e shërbimeve.

Ne e mbështesim këtë proces të llogaridhënies përmes:

Auditimit të Rregullsisë: një kombinim i auditimit financiar (i cili vërteton nëse informacioni financiar në Pasqyrat Vjetore Financiare është i saktë dhe konsistent me kornizën për raportimin financiar) dhe auditimit të pajtueshmërisë (i cili konfirmon nëse proceset dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret relevante); dhe

Auditimit të Performancës, i cili vërteton nëse institucionet, projektet ose programet ofrojnë ekonomicitet, efikasitet dhe/ose efektivitetet në përdorimin e burimeve. Raportet tona, duke përfshirë Raportin Vjetor të Auditimit, promovojnë llogaridhënien mes Kuvendit, Qeverisë dhe institucioneve publike, si dhe në secilin nivel individual. Publikimi i të gjitha raporteve tona i lejon qytetarët që të kërkojnë llogari nga kujdestarët e burimeve publike.

Numri i raporteve të shqyrtuara nga KMFP ka treguar më herët rritjen e llogaridhënies në sektorin publik, një trend zhvillimi i cili u ndërpre në 2014 për shkak të sfidave në formimin e Kuvendit. Krahas kësaj, ne kemi ofruar këshilla për një varg çështjesh që mbështesin zhvillimet në Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MF/K).

Rritja e llogaridhënies është gjithnjë e më e rëndësishme duke pasur parasysh situatën e buxhetit të mangët dhe ambicet për integrimin në BE. Menaxherët duhet të demonstrojnë në mënyrë të qartë që ata i kuptojnë kërkesat në rritje të qeverisjes dhe iniciativat e lidhura me llogaridhënien të cilat duhet të zbatohen. Aktivitetet tona orientohen gjithnjë e më shumë në mbështetje të kësaj

çështje, krahas institucioneve tjera, si dhe në zhvillimin e Kontrolleve të Brendshme të Financave Publike (KBFP-së) dhe të Menaxhimit të Financave Publike (MFP-së) në përgjithësi.

Megjithatë, janë zhvillimet e brendshme brenda secilit institucion ato të cilat do ti japin drejtim ndryshimit dhe zyrtarët përgjegjës duhet të vejnë theksin në:

- Menaxhimin dhe zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm;
- Plotësinë dhe efektivitetin e sistemeve të raportimit të brendshëm dhe kontrollit të brendshëm së bashku me përdorimin më aktiv të vetë-vlerësimit duke iu përgjigjur me kohë zbrazëtirave të identifikuara; dhe
- Zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të auditimit të brendshëm për t'i ofruar menaxhmentit siguri efektive;

Duke pasur parasysh kufizimet buxhetore dhe rritjen e pritshmërive të qytetarëve dhe partnerëve ndërkombëtarë nga institucionet e sektorit publik, këto të fundit kanë përpara sfida të rëndësishme menaxheriale. Kjo kërkon më shumë fokusim në menaxhimin e rrezikut dhe sistemet e duhura që zbusin rreziqet. Ngjashëm me të, është e nevojshme që theksi të vihet në arritjen e vlerës më të mirë për para në përdorimin e burimeve të pakëta. Raportimi i saktë për rezultatet e arritura duhet të jetë një aspekt i integruar në këto ambicie.

Përgjegjësitë e llogaridhënies për adresimin e këtyre kërkesave duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë. Nëse kërkesat për ndryshim nuk adresohen në mënyrë aktive atëherë edhe përfitimi nga identifikimi i tyre do të jetë i kufizuar.

3. RAPORTI VJETOR FINANCIAR PËR BUXHETIN E KOSOVËS

Konkluzioni i Përgjithshëm

Ministria e Financave (MF) ka konsoliduar Pasqyrat Vjetore Financiare për Buxhetin e Kosovës për vitin 2014 në pajtueshmëri me SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme". Megjithatë, kontrollet jo efektive në përgatitjen e buxhetit kanë rezultuar me një vlerë materiale të keq klasifikimit të shpenzimeve në pasqyrat financiare. Kjo kryesisht ka të bëjë me klasifikimin e mallrave dhe shërbimeve dhe po ashtu subvencioneve si Investime Kapitale. Po ashtu, cilësia e informatave lidhur me shpalosjet duhet të rritet për të qartësuar llogarit e arkëtueshme në nivel shtetërorë, llogarit e pagueshme dhe borxhin e brendshëm publik.

Opinionit i AP-së është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare të Buxhetit të Kosovës paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve të mëposhtme:

Shpenzimet për mallra dhe shërbime si dhe subvencione dhe transfere në vlerë prej 24,470,260€ ishin keq klasifikuar si investime kapitale. Kjo ka ndodhur pjesërisht për shkak të drejtimit nga Ministria e Financave në buxhetimin joadekuat të shpenzimeve si dhe pjesërisht nga veprimet jo të përshtatshme të organizatave buxhetore individuale në klasifikimin e tyre.

(SNISA 200/1705: Opinion i kualifikuar)

Më tutje, MF në Pasqyrat Vjetore Financiare për Buxhetin e Kosovës kishte shpalosur kufirin e deficitit buxhetor. LMFPP¹ përcakton kufirin e deficit buxhetor prej 2% të BPV-së së parashikuar. Megjithatë, rishikimi ynë ka nxjerr në pah se Qeveria e Kosovës kishte dërguar projekt ligjin e buxhetit për 2014 në Kuvendin e Kosovës me një deficit të përgjithshëm buxhetor prej 2.59%. Si i tillë, kufiri i deficit buxhetor ishte tejkaluar për 0.59%. Po ashtu, transaksionet ndërqeveritare nuk janë konsoliduar në PVF/BK duke rezultuar në mbivlerësim prej 4,335,251€.

E vlenë të theksohet se, struktura e shpenzimeve ka pësuar ndryshime të theksuara në 2014. Shpenzimet për Paga dhe Meditje janë rritur për 16%, ndërsa, shpenzimet për Investime Kapitale janë zvogëluar për 22%. Zvogëlimi i shpenzimeve kapitale dhe rritja e shpenzimeve operative nuk ndihmojnë zhvillimin ekonomik të vendit. Borxhet në nivel shtetëror nuk janë trajtuar me seriozitetin e duhur. Shqetësim mbetet shkalla e ulët e mbledhjes së të hyrave nga tatimet, kthimi i kredisë nga KEK-u dhe rritja e vazhdueshme e obligimeve të papaguara nga organizatat buxhetore (OB-të).

Më tutje, edhe kontrollet në procesin buxhetor ishin të pamjaftueshme pjesërisht për shkak të ngërçit politik. Edhe pse realizimi i buxhetit në përgjithësi ishte në nivelin e duhur, procesi buxhetor për investime kapitale dhe mallra dhe shërbime duhet të zhvillohet më tutje. Po ashtu, kontrollet jo adekuate në menaxhimin e pagesave kanë rezultuar me rritjen e trendit të kryerjes së pagesave përmes vendimeve gjyqësore dhe vendimeve të drejtpërdrejta nga Thesari.

¹ Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (nr. 04/ L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03 / L-048

Këto dhe dobësit e tjera të cekura në raport zvogëlojnë transparencën dhe efektivitetin e raportimit financiar në një kohë kur partnerët ndërkombëtarë presin një menaxhim sa më efektiv financiar. Në veçanti, aspiratat për integrim në BE kërkojnë një regjim kontabiliteti efektiv.

3.1 HYRJA DHE QASJA E AUDITIMIT

PVF/BK përmbledhin transaksionet në lidhje me pothuajse të gjitha aktivitetet e Qeverisë². MF, në emër të Qeverisë, përgatit PVF/BK të vitit fiskal jo më larg se me 31 Mars të vitit pasues. Ato duhet të përgatiten sipas kornizës së përgjithshme të krijuar nga LMFPP dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme".

Neni 47.1 i LMFPP-së përcakton se ZAP është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF/BK.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me ekzekutimin, dhe Pasqyrën e konsoliduar të pasurive në para të gatshme dhe bilancit të fondit;
- Nëse këto pasqyra financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare për periudhën e auditimit; dhe
- Nëse janë ndërmarr masat e duhura nga Qeveria për implementimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP) për vitin 2013 dhe vitet e mëhershme.

Auditimi i PVF/BK-së për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në Sektorin Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë është bazuar në një kuptim të plotë të procesit nëpër të cilin PVF/BK janë hartuar. Kjo na ka mundësuar që të zhvillojmë një strategji auditimi, e cila përqendrohet në adresimin e rreziqeve specifike për një opinion të pamodifikuar ndërkohë që ofron një nivel të mjaftueshëm të sigurisë në pasqyrat financiare si tërësi.

Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit dorëzuar në MF në shkurt 2015 dhe reflekton një vlerësim të rezultateve të auditimeve të OB-ve të cilat janë konsoliduar në PVF/BK.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Si të tilla, të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat mund të ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

² Këtu nuk përfshihen Aktivitetet e Bankës Qendrore, Fondit të Trustit të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Inteligjencës

3.2 OPINIONI I AUDITIMIT

Sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare të Buxhetit të Kosovës paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve të mëposhtme:

Shpenzimet për mallra dhe shërbime si dhe subvencione dhe transfere në vlerë prej 24,470,260€ ishin keq klasifikuar si investime kapitale. Kjo ka ndodhur pjesërisht për shkak të drejtimit nga Ministria e Financave në buxhetimin joadekuat të shpenzimeve si dhe pjesërisht nga veprimet jo të përshtatshme të organizatave buxhetore individuale në klasifikimin e tyre.

(SNISA 200/1705: Opinion i kualifikuar)

3.3 RREZIKU DOMETHËNËS NË PASQYRAT VJETORE FINANCIARE

Në PVF/BK-së 2014 kemi identifikuar rrezikun material lidhur me prezantimin e shpenzimeve në kategori ekonomike të gabuara. Proceset jo efektive në planifikimin dhe realizimin e buxhetit për vitin 2014 kanë rezultuar me një vlerë materiale të keqë klasifikimeve. Këto kryesisht kanë të bëjnë me klasifikimin e mallrave dhe shërbimeve dhe poashtu të subvencioneve si investime kapitale. Si pasojë, janë mbivlerësuar investimet kapitale ndërsa janë nënvlerësuar mallrat dhe shërbimet dhe subvencionet. Vlera totale e keq klasifikimeve të shpenzimeve në të gjitha OB-të është 24,470,260€. Prej tyre 15,669,042€³ ishin të buxhetuara gabimisht nga MF ndërsa pjesa tjetër ishin të buxhetuara gabimisht nga vet OB-të.

3.4 PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË BUXHETIT TË KOSOVËS PËR 2014

Rishikimi ynë i PVF/BK-së ka marrë parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu kemi marrë parasysh deklaratën e bërë nga Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit kur draft PVF/BK-së iu dorëzuan Kuvendit dhe AP.

Kjo përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Kjo ka për qëllim t'i ofrojë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

MF i ka dorëzuar PVF/BK-së 2014 në afatin ligjor, me 31 mars 2015. PVF/BK –së kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme". Megjithatë, shpenzimet për investime kapitale, mallra dhe shërbime dhe subvencione nuk janë klasifikuar në kategoritë ekonomike adekuate.

Marrë parasysh këtë-Deklarata e bërë nga Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtet, në përjashtim të keq klasifikimit të shpenzimeve.

³ Librat shkollor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në vlerë prej 10,035,353€, Mirëmbajta e rrugëve në Ministrinë e Infrastrukturës 5,715,302€, vakcina për kafshë në Zyrën e Kryeministrit 1,548,272€ dhe Provizionet bankare në Ministrinë e Financave 1,061,881€

3.4.1 ÇËSHTJE TJERA TË KONSOLIDIMIT NË PASQYRAT VJETORE FINANCIARE

Përveç rrezikut domethënës të identifikuar më lart, ne kemi identifikuar edhe një numër fushash të tjera, të cilat ne nuk konsiderojmë që paraqesin rrezik domethënës për anomali materiale në pasqyrat financiare, por janë çështje të cilat duhet të merren në konsideratë nga Qeveria.

Pagesat nga Palët e Treta - Në vitin 2014, MF-ja ka hartuar udhëzime të qarta për raportimin e pagesave nga palët e treta. Të gjitha pagesat nga palët e treta duhet të regjistrohen në SIMFK dhe ato të raportohen në PVF të BK-së. Për këtë, cdo marrëveshje e arritur në mes të OB-ve dhe donatorëve, qoftë për pagesat e drejtpërdrejta apo për pagesat nëpërmjet Thesarit, duhet paraprakisht të paraqitet në Thesar për regjistrim. Në disa raste OB-të nuk e kanë bërë këtë. Andaj, vlera e pagesave nga palët e treta (donacionet) të paraqitura në PVF/BK-së është e nënvlerësuar për rreth 4,500,000€. Në PVF/BK janë raportuar vetëm 2,288,000€ në krahasim me vlerën totale prej 6,895,614€ të raportuara në PVF individuale të OB-ve.

Transaksionet ndërqeveritare - nuk janë konsoliduar në PVF/BK duke rezultuar në mbivlerësim prej 4,335,251€ të vlerave që bartin këto transaksione. E njëjta gjë ka ndodhur edhe viteve paraprake. Thesari vazhdon të mos e kryej konsolidimin e transaksioneve ndërqeveritare sepse sipas tyre, kjo ruan konsistencën dhe krahasueshmërin me informacionin e raportuar në vitet e mëparshme.

Të dhënat Financiare - PVF/BK-së nuk përmbajnë informata të mjaftueshme për llogarit e arkëtueshme në nivel shtetërorë, llogarit e pagueshme dhe borxhin e brendshëm publik. Këto informata do të rrisnin cilësinë e PVF/BK-se dhe do t'i ndihmonin lexuesve të kuptojnë më mirë tendencat dhe gjendjen financiare të buxhetit për vitin aktual dhe krahasimin me vitet e kaluara.

Klasifikimi i shpenzimeve -Pagesa për Anëtarësim në IFN⁴/Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në vlerë prej 717,000€ është regjistruar dhe raportuar në PVF/BK-së gabimisht në kategorinë mallra dhe shërbime. Kjo është dashur të regjistrohej dhe raportohet në shënimin 27. Pagesat për anëtarësim në IFN, për të reflektuar vlerën e plotë të pagesave për anëtarësim në IFN.

Më tutje, edhe në kodin ekonomik "Kapital Tjetër" janë regjistruar dhe raportuar gabimisht shpenzimet në vlerë prej 47,714,405€. Shpenzimet ishin për blerjet e kompjuterëve, zhvillimin e softuerëve, riparimin dhe renovimin e ndërtesave, mirëmbajtjen e rrugëve, furnizim me material shpenzues, furnizim me libra etj. Megjithatë në vitin 2015, kjo është marrë parasysh dhe Thesari ka bërë jo aktiv kodin Kapital tjetër.

Këto dobësi zvogëlojnë transparencën dhe efektivitetin e raportimit financiar në një kohë kur partnerët ndërkombëtar presin një menaxhim sa më efektiv financiar. Aspiratat për integrim në BE kërkojnë një regjim më efektiv të kontabilitetit.

⁴ Institucionet Financiare Ndërkombëtare

3.4.2 OPINIONET E AUDITIMIT TË PVF INDIVIDUALE PËR VITIN 2014

Kemi kryer auditimin statutor të rregullsisë së PVF-ve për 90 OB. Përveç këtyre, edhe për dy organizata⁵ jashtë buxhetit. Opinionet e dhëna për secilën OB reflektohen në opinionin e auditimit të PVF/BK-së. . Opinionet e dhëna janë si në vijim:

Tabela 1. Lloji dhe numri i opinionëve për PVF individuale të OB-ve

Entitetet e audituara/ Opinionet	Opinion i pa modifikuar	Opinion i pa modifikuar me Theksim Çështje	Opinion i kualifikuar	Opinion i kualifikuar me Theksim Çështje	Mohim i opinionit	Nr. Opinionëve
Nivelin Qendrorë	11	10		3		24 ⁶
Niveli Komunitat	1	17	2	14	4	38
Agjencitë e Pavarura	22	4	1	1	0	28
Jashtë buxhetit	2					2
Gjithsej	36	31	3	18	4	92 ⁷

Ndikimi i këtyre opinionëve në PVF/BK-së është material siç është cekur në nënkapitullin 3.3. Çështjet e tjera si pasuria dhe pagesat nga palët e treta nuk kishin ndikim material në PVF/BK-së. Për më shumë detaje lidhur me opinionet e auditimit për secilën OB referoju Shtojcës nr. 2.

3.5 DEKLARATA LIDHUR ME VLERËSIMIN E PAJTUESHMËRISË PËR KUFIRIN E DEFICITIT BUXHETOR PËR VITIN 2014

Bazuar në LMFP nr.04/L-194⁸, auditimi i PVF/KB-së duhet të përfshijë një vlerësim të pajtueshmërisë për kufirin e deficitit buxhetor i cili nuk duhet të kalojë nivelin prej 2% të BPV-së⁹ së parashikuar.

Ne kemi shqyrtuar proceset brenda MF-së për kërkesat e këtij ligji lidhur me kufijtë e deficitit buxhetor për të na mundësuar dhënien e një deklaratë në lidhje me pajtueshmërinë me kufirin e deficitit dhe kushtet dhe kërkesat ligjore. Vlerësimi ynë ka nxjerrë në pah se kontrollet gjatë përgatitjes së buxhetit për 2014 nuk kishin funksionuar si duhet. Si rezultat, Ligji për ndarjet buxhetore ishte aprovuar me një tejkalim të kufirit të deficitit buxhetor.

Sipas LMFP, deficit i përgjithshëm buxhetor nuk duhet të tejkalojë 2% të pragut të BPV-së. Ligji i buxhetit për vitin 2014 i miratuar nga Kuvendi ka lejuar deficit buxhetor prej 2,59% të BPV-së duke tejkaluar kufirin e vendosur për 0,59%. Në fund të vitit 2014, deficit aktual ishte 2,23% e BPV-së.

⁵ Projekti TAMAD dhe Fondi i Bashkuar për Sektorin e Arsimit

⁶ Ne kuadër të Ministrive janë të përfshira edhe opinionet për Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Presidencës, Zyrën e Kryeministrit, Doganë dhe Administratën Tatimore të Kosovës.

⁷ Dallimi mes numrit të institucioneve të audituara dhe opinionëve të dhëna është se Auditori i Përgjithshëm është i obliguar të japë dy opinionë ndaras sa i përket AKP-së, një për institucionin dhe një për Fondin e Privatizimit

⁸ LMFP nr. 04 / L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116

⁹ Sipas ligjit të buxhetit për vitin 2014, BPV e parashikuar për vitin 2014 ishte 5,509,000,000€.

Sa i përket kërkesave të LMFP-së, për qëllime të matjes së pajtueshmërisë me kufirin e deficitit (llogaritjes së deficitit) nuk janë marr parasysh pikat e mëposhtme:

- financimi i buxhetit nga huamarrjet e brendshme dhe të jashtme ;
- shpenzimet e Agjencionit Kosovar të Privatizimit ; dhe
- shpenzimet buxhetore që mund të rezultojnë nga shpenzimi i të hyrave vetanake të nivelit qendror dhe komunal të bartura nga vitit paraprak.

Tabela 2. Deficiti buxhetor për 2014

	Buxheti 2014 €'000	Realizimi 2014 €'000
Të hyrat	1,456,652	1,332,822
Të hyrat tatimore	1,264,127	1,141,157
Të hyrat nga dogana	934,109	870,978
Kthimet nga Dogana	(3,729)	(2,408)
Të hyrat vendore	367,306	303,695
Kthimet nga ATK-ja	(33,558)	(31,108)
Të hyrat jo-tatimore	47,799	47,386
Tantiemat	22,000	26,539
Të hyrat vetanake	117,226	97,446
Niveli qendror	50,000	36,490
Komunat	67,226	60,955
Dividenta	-	15,000
Taksa koncensionare	5,500	5,293
Shpenzimet	1,589,325	1,463,523
Pagat dhe mëditjet	487,161	485,247
Mallrat dhe shërbimet	255,411	205,756
<i>(nga të cilat komunalite)</i>	27,092	22,099
Subvencionet dhe transferet	314,099	361,160
Shpenzimet kapitale	530,476	411,360
Rezerva	2,177	-
Deficiti/suficiti primar	(132,673)	(130,701)
Pagesa e Interesit	(17,000)	(12,462)
Deficiti i përgjithshëm (rregulla fiskale)	(149,673)	(143,163)
Shpenzimet nga të hyrat vetanake të bartura		15,241
Shpenzimet AKP-së	7,000	5,443
Deficiti/suficiti i përgjithshëm	(142,673)	(122,479)
Deficiti/suficiti i përgjithshëm në %	-2.59%	-2.23%

Në PVF/BK-së, Qeveria ka prezantuar deklaratën e kalkulimit të deficitit buxhetor, mirëpo nuk janë dhënë shënime sqaruese në lidhje me shkaqet e tejkalimit të kufirit. 3.6 Analiza e Pasqyrave

3.6 ANALIZA E PASQYRAVE VJETORE FINANCIARE DHE SHPALOSJET 2014

Të dhënat e prezantuara në PF/BK janë reflektim i pranimeve dhe pagesave reale dhe ndarjeve buxhetore përkatëse. Qeveria përmes vendimeve gjatë vitit ka bërë përshtatjet dhe transferet në kuadër të programeve dhe kategorive ekonomike tek OB. Procesi buxhetor vazhdon nëpër vite të përcjellët me mangësi të ndryshme në të gjitha fazat e tij nga buxhetimi, realizimi dhe monitorimi. Ne kemi analizuar tre pasqyrat kryesore të Raportit Vjetor Financiar të Buxhetit të Kosovës dhe po ashtu edhe informatat e shpalosura.

3.6.1 ANALIZA E PASQYRAVE VJETORE FINANCIARE

Pasqyra e Konsoliduar e krahasimit të buxhetit me ekzekutimin

Buxheti final për pranimet ishte i njëjtë me buxhetin fillestarë. Ndërsa, buxheti final për pagesat në raport me buxhetin fillestarë ishte më i lartë për 34,871,000€.

Tabela 3. Buxheti fillestar dhe realizimi i pranimeve në raport me pagesat (000 në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2014	Realizimi 2013	Realizimi 2012
Pranimet	1,641,545	1,641,545	1,448,957 ¹⁰	1,428,704	1,537,955
Pagesat	1,627,945	1,655,921	1,498,400 ¹¹	1,500,176	1,466,457
Suficiti/Deficiti	13,600	-14,376	-49,443	-71,472	71,498

Çështjet kryesore të dalura nga analizat tona janë si në vijim:

- Deficiti i planifikuar për vitin 2014 ishte 14,376,000€ derisa deficiti i realizuar ishte 49,433,000€. Deficiti vjetor është 3,4% i të hyrave të përgjithshme vjetore dhe ishte financuar nga suficiti i akumuluar ndër vite.
- Pranimet e vitit 2014 në raport me 2013 janë rritur për 20,253,000€ apo 1.4%. Rritja ishte rezultat i rritjes së të hyrave tatimore, financimit nga huamarrja si dhe rritja e të hyrave vetanake. Përderisa, të hyrat nga dividendat krahasuar me 2013 janë zvogëluar për 28,000,000€;. Pranimet ishin për 12% më të vogla se planifikimi. Kjo për arsye se Administrata Tatimore (ATK) nuk kishte arritur të përmbush planin plotësisht.
- Të hyrat e planifikuara doganore për vitin 2014 ishin 930,380,000€, ndërsa ishin realizuar 868,570,000€ apo 93,3% e planit. Në raport me vitin 2013 kishte rritje prej 34,490,000€¹² apo 4,14%. Rritja është ndikuar nga akciza e jashtme në kufi në vlerë prej 17,083,000€e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së sasisë së importit të derivateve, importit të birrës dhe rritja e normës së akcizës për cigare krahasuar me vitin paraprak;

¹⁰ Ne totalin e pranimeve nuk janë të përfshira pranimet nga GDP në vlerë prej 12,092,000€ dhe pranimet nga depozitat 1,529,000€

¹¹ Ne totalin e pagesave nuk janë të përfshira pagesat nga GDP në vlerë prej 11,462,000€ si dhe kthimet nga fondet e depozitave në vlerë prej 993,000€

¹² Kjo rritje vjere nga akciza e jashtme në kufi në vlerë prej 17,083,000€, Tatimi mbi vlerën e shtuar 11,665,000€ si dhe rritja e të hyrave taksa doganore 6,195,000€.

- Të hyrat e planifikuara nga ATK për vitin 2014 ishin 333,748,000€, ndërsa ishin realizuar 272,587,000€ apo 82% e planit. Shkalla e ulët e realizimit shpjegohet me rënie të investimeve të huaja direkte si dhe investimeve kapitale qeveritare të cilat në vitin 2014 janë zvogëluar për 121,770,000€. Si rezultat i këtij ndikimi zingjiror shkaktuar edhe kontraktimet e ulëta të operatorëve ekonomikë dhe nënkontraktorëve të tyre, përcjellë me rënie të TVSH-së në raport me planifikimin;
- Shqetësim i ATK-së vazhdon të mbetet shkalla e lartë borxheve të pa-inkasueshme, të cilat në fund të vitit 2014, ishin 277,823,490€. Në raport me 2013 kishte një rritje prej 24,326,786€ apo 10%. Sfidë tjetër ndaj kësaj do jetë vendimi i Qeverisë dhe ligji i rradhës për faljen e borxheve.

Analiza e pagesave në para të gatshme

Tabela 4. Buxheti final dhe realizimi për 2014¹³

(`000 në €)

Përshkrimi	Buxheti final	Realizimi 2014	% e Realizimit	Realizimi 2013	Realizimi 2012
Pagat dhe Mëditjet	496,489	485,247	97,7%	417,093	407,706
Mallrat dhe Shërbimet	213,396	183,658	86%	193,857	169,362
Shpenzimet Komunale	25,346	22,099	87,1%	21,662	21,558
Subvencionet dhe Transferet	367,326	361,160	98,3%	312,916	280,120
Shpenzimet Kapitale	514,743	411,360	80%	529,176	550,245
Rezervat	-	-	-	-	-
Nën totali	1,617,300	1,463,525	90,4%	1,474,704	1,428,991
Pagesa e borxhit	38,620	34,877	90,3%	25,472	21,416
Huazimet për NP	-	-	-	-	15,000
Anëtarësimi në IFN	-	-	-	-	1,050
Nën totali	38,620	34,877	90,3%	-	37,466
Gjithsej	1,655,920	1,498,400	90,4%	1,500,176	1,466,457

Cështjet kryesore të dalura nga analizat tona janë si në vijim:

- Krahasuar me 2013, struktura e shpenzimeve ka pësuar ndryshime të theksuara në 2014. Shpenzimet për 2014 pasqyrojnë vendimin e Qeverisë për rritjen e pagave me 25% nga 1 prilli dhe reduktimin e mallrave dhe shërbimeve me 15%. Kjo dhe rritja e subvencioneve dhe transfereve ka bërë që shpenzimet kapitale të reduktohen ndjeshëm. Shpenzimet për Paga dhe Mëditje janë rritur në vlerë prej 68,154,000€ apo 16,3%, Subvencionet dhe Transferet janë rritur për 48,244,000€ apo 15,4%. Ndërsa, shpenzimet për Investime Kapitale janë zvogëluar për 117,816,000€ apo 22,2%. Si dhe pagesa e borxhit është rritur për 9,405,000€ apo 36,9%;
- OB-të si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal nuk e kanë realizuar buxhetin vjetor sipas planeve të rrjedhës së parasë së gatshme. 39% e totalit të pagesave për kapitale në nivelin qendror dhe 31% e pagesave për kapitale në nivelin lokal kanë ndodhur në fund të vitit përkatësisht në nëntor dhe dhjetor. Numri voluminoz i lëndëve për procedim në fund vit ka rezultuar me kontrole të mangëta në OB në lidhje me kompletimin dhe certifikimin e pagesave;

¹³ Nuk janë të përfshira pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve

- Buxhetimi i Pagave dhe Mëditjeve në nivel qendrorë nuk ishte i mirë. Sipas Ligjit për ndarjet buxhetore nr 04/L-233 buxheti për paga dhe meditje ishte 496,489,000€. Prej tyre, vetëm për nivelin qendror ishte 265,917,147€, ndërsa numri i të punësuarve 37,405€. Buxheti për këtë nivel ishte shpenzuar pothuajse 100% dhe sikur të punësoheshin të gjithë zyrtarët e planifikuar buxheti për 2014 nuk do të ishte i mjaftueshëm;
- Buxheti final për projekte kapitale për 2014 ishte 514,743,000€ ndërsa realizimi ishte 412,919,507€ apo në përqindje 80% e planit. Projektet kapitale në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal nuk ishin realizuar sipas planit. Zvogëlimi i investimeve kapitale në 2014 lidhet kryesisht me përfundimin e projektit të autostradës R-7(infrastuktura rrugore) dhe poashtu me mos implementimin e projekteve kapitale nga OB-të. Kjo ka shkaktuar vështërsi në arritjen e planeve operationale dhe në përmbushjen e objektivave të OB-ve e cila po ashtu ka ndikuar në zvogëlimin e investimeve në sektorin privat. Mos realizimi i projekteve në sektorin publik mund të ketë ndikim negativ në aktivitetin e ndërmarrjeve private që ekzekutojnë këto projekte;
- Vlera e përgjithshme e granteve të pranuar për 2014 ishte 23,999,000€¹⁴. Fondet e granteve nuk ishin shfrytëzuar në nivel të kënaqshëm. Per 2014 janë shpenzuar 13,751,000€. Bilancet e mjeteve të pa shpenzuara nga fondet e granteve janë rritur gjatë tre viteve të fundit. Bartja e mjeteve të pashfrytëzuara nga viti në vit, tregon se këto fonde nuk po menaxhohen sa duhet dhe as nuk po shfrytëzohen për qëllimet e dedikuara. Kjo rrit rrezikun që grantet nga donatorët në të ardhmen do të zvogëlohen sepse shihet se ato nuk po menaxhohen në mënyrë aktive; dhe
- Për dallim nga viti 2013, në vitin 2014 ishte një situatë ndryshe sa i përket vendndodhjes apo lëvizjes së fondeve. Në llogarinë kryesore gjendja e fondeve në fund të 2013 ishte 12,900,000€ ndërsa në fund të 2014 gjendja e këtyre fondeve është 90,481,000€. Ministri i Financave në pajtim me Ligjin e buxhetit nr. 04/L- 233, ka ndarë 46,000,000€ si fonde për ruajtjen e asistencës emergjente për likuiditet dhe ka rritur fondet në llogarinë e bankës qendrore për 31,743,000€ në raport me vitin 2013.

3.6.2 SHPALOSJA E PASURIVE JO FINANCIARE DHE DETYRIMET E PAPAGUARA

Çështjet kryesore të dalura nga analizat tona janë si në vijim

Pasuritë jo financiare

Menaxhimi i pasurisë publike është pjesë e veçantë e Menaxhimit Financiar dhe sfidat e OB janë prezantuar në kapitujt e tjerë në vijim. Konsolidimi dhe raportimi i pasurive është përmirësuar në krahasim me 2013.

Sipas PVF/BK, vlera neto e pasurisë kapitale është 4,942,348,487€ e përbërë nga 2,105,236,669€ nga OB-të e nivelit qendror dhe 2,837,111,818€ nga ato të nivelit lokal. Vlera e pasurive kapitale e shpalosur në PVF/BK-së ishte e njëjte me pasuritë e shpalosura në PVF e OB-ve. Ndërsa, vlera neto e pasurisë jokapitale është 48,103,836€ e përbërë nga 31,379,487€ nga OB-të e nivelit qendror dhe 16,724,349€ nga ato të nivelit lokal.

¹⁴ Ne këtë janë përfshirë edhe grantet e bartura nga viti paraprak.

Obligimet e papaguara

Obligimet e papaguara të OB-ve në fund të 2014 janë 165,387,912€. Prej tyre 148,200,865€ i takojnë nivelit qendror dhe 17,157,439€ nivelit lokal. Kjo vlerë është bartur për pagesë në 2015. Krahasuar me 2013, obligimet janë rritur për 111,731,584€.

Tabela 5 Obligimet e papaguara

(000€)

Përshkrimi	2014	2013	2012
Niveli Qendror	148,199,227	29,940,831	13,875,768
Niveli Lokal	17,188,685	23,685,889	12,811,832
Gjithsej	165,387,912	53,626,720	26,687,600

Rritja e obligimeve krahasuar me 2013 ishte rezultat i rritjes së obligimeve në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Obligimet e papaguara për MMPH për 2014 janë 114,390,183€. Prej tyre, 113,802,657€ janë obligime të cilat kanë rezultuar nga Vendimet e Qeverisë për Shpronësim për vitet 2010-2014. Ndërsa, pjesa tjetër prej 587,526€ ishin fatura të papaguara nga MMPH për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe investime kapitale.

Obligimet si rezultat i shpronësimit në MMPH nuk janë kryer për shkak të mos aplikimit për pagesë të përfituesve privat nga shpronësimi si dhe në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm për pagesa. Derisa, në pjesën dërmuese të rasteve tjera është vënë në kontest pronësia dhe nuk ka aplikime për pagesën e këtyre pronave.

Obligimet e papaguara në nivel qendror, duke përjashtuar MMPH, në 2014 janë 34,396,570€, ku vlera prej 18,724,025€ i takon obligimeve të papaguara të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR). Këto obligime kishin të bënin me subvencionet në bujqësi. Krahasuar me vitin 2014, obligimet në nivelin qendror duke përjashtuar MMPH janë rritur për 4,455,739€. Përderisa, qeveria lokale kishte menaxhuar obligimet më mirë, krahasuar me 2013 ato janë zvogëluar për 6,497,204€ ose për 27%, menaxhimi jo efektiv i obligimeve të papaguara mund ti vë në vështësi buxhetore OB duke pamundëuar arritjen e objektivave vjetore dhe po ashtu ngarkon buxhetet pasuese.

Obligimet e papaguara reflektojnë në mënyrë direkte dhe ngarkojnë buxhetin e vitit vijues dhe potencialisht ndikojnë në mos arritjen e objektivave të OB-ve.

Obligimet e MMPH-së në raport me buxhetin janë 254%, MBPZHR¹⁵ janë 78%, Shtërpca me 34%, Kllokoti me 28%, Gjakova me 17% dhe Gjlani me Junikun me nga 10%.

Kredi për Korporatën Energjetike të Kosovës

Vlera totale që Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka tërhequr nga Buxheti i Kosovës 202,539,992€. Deri në fund të 2014, KEK ka arritur të kthejë vetëm kredinë e parë të nënshkruar në vitin 2005 në vlerë 10,000,000€. Përveç kësaj, KEK ka paguar interesin prej 7,081,488€.

¹⁵ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Borxhi i mbetur i KEK-ut është 225,456,009 €. Në këtë vlerë janë të përfshira interesi i akumuluar i papaguar dhe ndëshkimet. Ri-programimi i borxhit nuk është bërë në 2014 për shkak të hendekut qeveritar. Me formimin e qeverisë së re, Qeveria ka marrë vendim për ri-programimin e marrëveshjeve financiare. Gjashtë marrëveshjet financiare janë konsoliduar në dy: kredinë për miniera: 165,4000€ me 20 vjet amortizim; dhe kredinë për gjenerim: 25,600,000€ me 10 vjet amortizim.

Sipas kushteve aktuale, KEK-u do të paguaj këstin e parë prej 1,500,000€ me 15 tetor 2015.

Pasqyra e borxhit të përgjithshëm

MF ka përgatitur Programin për Borxhin Shtetëror në të cilin ka paraqitur politikën kombëtare për borxhin dhe Strategjinë për Menaxhimin e Borxhit dhe të huamarrjes. Këto ishin bërë në përputhje me kornizën makroekonomike dhe fiskale për të siguruar një pozitë të qëndrueshme të huamarrjes.

Tabela 6 Pasqyra e borxhit të jashtëm dhe të brendshëm

NR	VITET	2014	2013	2012
1	BORXHI NDËRKOMBËTAR	326,350,000	323,760,000	336,600,000
2	Niveli Qendror	316,540,000	321,730,00	336,460,000
3	Nën huazimet	9,810,000	2,030,000	140,000
4	Niveli Lokal	0,00	0,00	0,00
5	BORXHI BRENDSHËM	256,520,000	152,510,000	73,310,000
6	Niveli Qendror	256,520,000	152,510,000	73,310,000
7	Niveli Lokal	0,00	0,00	0,00
8	Gjithsej Borxhi i përgjithshëm (% BPV)	10.63%	9.10%	8.44%
Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm		582,870,000	476,270,000	409,920,000

Borxhi i përgjithshëm është 582,870,000€. Prej tyre, borxhi i brendshëm është 256,520,000€¹⁶, dhe borxhi i jashtëm 326,350,000€¹⁷. Qeveria ka paguar kryegjënë dhe interesin në kohë dhe në pajtueshmëri me marrëveshjet individuale dhe Ligjin mbi Borxhin Publik. Krahasuar me 2013, borxhi publik është rritur për 106,600,000€ apo 22.3% si rezultat i financimit të projekteve buxhetore.

Borxhi i përgjithshëm ndaj të hyrave vjetore të Qeverisë për 2014 ka qenë 40.2%. Rritja vjetore e borxhit është e kufizuar me BPV me anë të rregullës fiskale, dhe përbën vetëm 10.63% të BPV. Për 2014, ka paguar interesin për borxhin e brendshëm 2,500,000€. Ndërsa për borxhin e jashtëm ka paguar kryegjënë 22,050,000€, interes 9,780,000€ dhe 540,000€ për kredinë e nën-huazuar.

¹⁶ Huadhënësit: Bankat komerciale me 75.3%, Fondet Pensionale 23.1%, dhe Të Tjerë 1.6%.

¹⁷ Huadhënësit: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim 59%, FMN 31%, dhe Të Tjerë 10%.

Pagesat me vendime të gjykatave dhe Nenit 39.2 të LMFPF

LMFPF neni 39 dhe 40 ka autorizuar Thesarin për kryerjen e pagesave kur një faturë nuk është paguar nga OB për një periudhë më të gjatë kohore se gjashtëdhjetë (60) ditë, si dhe kryerjen e pagesave si rezultat i vendimeve gjyqësore. Pagesat me vendime të gjykatave dhe me vendime të Thesarit për vitin 2014 ishin 9,649,691€. Krahasuar me 2013, kemi rritje për 6,647,023€.

Tabela. 7 Pagesat me vendim të Gjykatës dhe vendim të nenit 39.2 të LMFPF-së

Pagesat me vendim te gjykatave	Niveli Lokal	Niveli Qendrore	Totali
Mallra dhe shërbime	1,038,665	353,020	1,391,685
Komunali	75,732	3,423	79,155
Subvencione dhe transfere	328,647	7,198	335,845
Investime Kapitale	232,560	4,131,591	4,364,151
Totali	1,675,604	4,495,232	6,170,836
Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFPF	Niveli Lokal	Niveli Qendrore	Totali
Mallra dhe shërbime	74,315	367,097	441,412
Investime Kapitale	2,457,319	580,124	3,037,443
Totali	2,531,634	947,221	3,478,855

Për shkak të vonesave në procedimin e pagesave nga ana e OB-ve, kontraktorët kanë kërkuar ekzekutimin e pagesave drejtëpërdrejt nga Thesari. Drejtori i Thesarit ka shqyrtuar kërkesat dhe si rezultat i vlefshmërisë së tyre ka kryer pagesat për kontraktorët në vlerë prej 3,478,855€. Ndërsa, vlera prej 6,170,836€ është kryer po ashtu në favor të kontraktorëve si rezultat i vendimeve gjyqësore. Prej tyre, 4,131,591€ janë paguar nga investimet kapitale të nivelit qendror në favor të kontraktorëve.

3.7 REKOMANDIMET

Rekomandojmë Qeverinë të sigurojë se:

- Me rastin e përgatitjes së Ligjit për Ndarjet Buxhetore për 2016 të siguroj se MF ka analizuar në hollësi mënyrën e tanishme të klasifikimit buxhetor dhe të përshtatë buxhetin në pajtim me Standardet e Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Më tutje, kontrollet lidhur me ruajtjen e kufirit të deficitit buxhetor duhet të forcohen për të siguruar që Ligji për ndarjet buxhetore të mos përfshijë një deficit buxhetor i cili tejkalon kufirin e lejuar me LMFPF;
- Procesi i konsolidimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Buxhetit të Kosovës duhet të përfshijë informata plotësuese për borxhet e brendshme, llogaritë e arkëtueshme në nivel shtetëror dhe të pagueshmet. Po ashtu, për të rritur efektivitetin e raportimit financiar, Qeveria duhet të sigurojë konsolidimin e transaksioneve ndërqeveritare, përmirësimin e procesit të regjistrimit të pagesave nga palët e treta dhe prezantimin e drejtë të pagesave në PVF/BK-së. Për ta siguruar këtë, MF duhet të udhëzojë OB-të për regjistrimin e pagesave nga palët e treta dhe të transaksioneve tjera të duhura në PVF-të e tyre individuale. Derisa PVF të OB-ve të cilat nuk i kanë të gjitha informatat e nevojshme dhe për këtë mund të shkaktojnë mos barazimin me PVF/BK-së ti kthejë mbrapa tek OB-të përkatëse për plotësim;

- Të forcoj mekanizmat monitorues në performancën buxhetore duke identifikuar dhe adresuar barrierat e mundshme ndaj realizimit të pranimeve si dhe ekzekutimit të buxhetit. Në këtë aspekt, të zbatohet një proces efektiv i menaxhimit të projekteve kapitale, duke siguruar monitorim pro-aktiv nga ana e OB-ve. Veç kësaj, duhen të veprime konkrete për të adresuar shkaqet e mos fillimit të projekteve me qëllim të eliminimit të barrierave në implementimin me kohë të kontratave konform planeve dinamike;
- Të shqyrtojë vjetërsinë dhe vlefshmërinë e borxheve individuale dhe të zbatojë një proces sistematik të trajtimit të atyre borxheve që konsiderohen të pa mbledhshme. Të gjitha mjetet në dispozicion të shfrytëzohen, përfshirë veprimet ligjore. Gjithashtu të bëjë një analizë në mënyrë që të nxjerr shkaktarët e dështimit të bizneseve në pagesën e borxheve;
- Është themeluar mekanizmi i cili do të analizonte shkaqet e rritjes së obligimeve nga viti në vit nëpër organizata buxhetore, me qëllim që obligimet e papaguara të zvogëlohen në një nivel të pranueshëm;
- MF duhet të mbaj përgjegjëse KEK-un për respektimin e marrëveshjes së re me rastin e ripogramimit të borxhit me qëllim që t'i përmbahet planit kreditor për pagesën e kryegjësë dhe interesit konform kushteve të reja; dhe
- Ka kërkuar nga Zyrtarët Kryesor Administrativ të OB-ve të sigurojnë që faturat e furnitorëve menaxhohen me kujdesin e shtuar dhe ato paguhen me kohë për të evituar rrethanat të cilat mund shkaktojnë pagesën e tyre drejtëpërdrejt nga MF apo edhe sipas vendimeve gjyqësore.

4. ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA NË VITET E MËPARSHME

Konkluzioni i Përgjithshëm

Rekomandimet e AP-së kanë për synim promovimin e Qeverisjes së mirë dhe përmirësimin e menaxhimit financiar. ZAP në vazhdimësi bën përcjelljen e mënyrës së implementimit të rekomandimeve të dhëna në RVA dhe në raportet individuale të auditimit. Shkalla e implementimit të rekomandimeve të kaluara, edhe në nivel të Qeverisë por edhe në nivel institucional akoma nuk është e kënaqshme, përkundër faktit se ka përmirësime me kalimin e viteve.. Kjo ka ndikuar që një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve të përsëritën edhe në Raportin Vjetor të Auditimit por edhe në raportet individuale të auditimit të organizatave buxhetore. Në implementimin jo të duhur të rekomandimeve ndër të tjera ka ndikuar edhe mos funksionimi aktiv i disa institucioneve si pasojë e ngërçit politik dhe mungesa e veprimeve të duhura nga institucionet përkatëse.

4.1 HYRJE

Ne gjatë vitit kemi kryer mbi 100 auditime. Për ta mbështetur procesin e implementimit të rekomandimeve, KMFP ka mbajtur takime publike me zyrtarët përgjegjës të OB-ve, por një numër i madh i rekomandimeve në fusha të rëndësishme të menaxhimit mbeten të pa adresuara.

4.2 ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA NË RVA PËR VITIN 2013 DHE 2012

Në raportin Vjetor të Auditimit për Pasqyrat e konsoliduara të Qeverisë së Kosovës për vitin 2013, AP kishte dhënë 48 rekomandime për Qeverinë, 15 për Kuvendin, 3 për kryetarët e komunave dhe 3 për Kuvendet Komunale. Nuk përgatitet ndonjë plan veprimi për adresimin e rekomandimeve të RVA-së. Megjithatë implementimi i këtyre rekomandimeve nuk ishte në nivelin e pritur – vetëm shtatë prej tyre janë implementuar plotësisht. Si pasojë e kësaj disa nga rekomandimet janë përsëritur edhe këtë vit. Për një përshkrim më të detajuar në lidhje me implementimin e këtyre rekomandimeve referojuni shtojcës III.

Përveç rekomandimeve të RVA-së për vitin 2013 ne kemi analizuar edhe implementimin e rekomandimeve të RVA-së për vitin 2012. Nga kjo analizë del se disa nga rekomandimet e dhëna në RVA-në e vitit 2012 edhe pse ishin përsëritur në raportin e vitit 2013, ato ende nuk janë adresuar.

Rekomandimet më të rëndësishme të që ende nuk janë adresuar janë:

- Sigurimi i transparencës në PVF/BK-së, duke klasifikuar dhe regjistruar të gjitha shpenzimet, në kodet adekuate të shpenzimeve, si dhe prezantimin e plotë të pagesave nga palët e treta;
- Analizimi i shkaqeve të detyrimeve të papaguara dhe ndërmarrjen e veprimeve të duhura për t'i zvogëluar ato në nivel të OB-ve;
- zhvillimi dhe zbatimi i një qasjeje efektive nga OB-të individuale për menaxhim të rrezikut në lidhje me objektivat organizative dhe misionin e tyre. Kjo të përdoret si bazë për forcimin dhe zhvillimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe efektiv të kontrollit;

- Ngritja e një task force të veçantë për shqyrtimin e realizimit të buxhetit dhe veprimet e ndërmarra lidhur me proceset e prokurimit dhe planifikimit për të hequr pengesat në rritjen e nivelit të realizimit të buxhetit. Theks i veçantë duhet të vihet tek pengesat për ekzekutimin efektiv të buxhetit për investimet kapitale;
- Futja në përdorim e prokurimit elektronik i cili do ta rriste transparencën dhe do të reduktonte procedurat burokratike;
- Gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme, kur është fjala për kryerjen e shërbimeve të auditimit të brendshëm në institucionet e pavarura të vogla që janë drejtpërdrejt përgjegjës para Kuvendit, e që do të nxisë pavarësinë dhe llogaridhënien;
- Futjen në funksion të një Menaxheri Ekzekutiv në Komuna si nëpunës më i lartë civil, përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve të përditshme dhe shërbimeve për qytetarët;
- Përcjelljen aktive të veprimeve të Qeverisë duke shikuar performancën e NP-ve në lidhje me politikat e vendosura për ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët, si dhe sfidat me të cilat përballen në këtë proces; etj.

4.3 ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA NË RAPORTET INDIVIDUALE TË AUDITIMIT PËR VITIN 2013 DHE 2012

Në raportet tona të auditimit ne japim edhe rekomandime për udhëheqësit e organizatave për adresimin e të gjeturave të identifikuara gjatë auditimit. Kjo i ndihmon ata që të përmirësojnë nivelin e qeverisjes, llogaridhënien publike, dhe shërbimet ndaj qytetarëve. Në këtë mënyrë AP jep kontribut në përmirësimin e menaxhimit financiar dhe në shfrytëzimin sa më të mirë të resurseve në dispozicion.

Pjesë e punës tonë gjatë kryerjes së auditimeve, është edhe monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitet paraprake. Gjatë auditimeve të PVF-ve të OB-ve individuale ne kemi analizuar mënyrën se si janë adresuar rekomandimet tona të mëhershme. Një analizë e tillë ka qenë subjekt i punës tonë në të gjitha auditimet individuale ku janë dhënë rekomandime të mëhershme. Rezultatet nga këto analiza i kemi përmbledhur në tabelat e mëposhtme. Organizatat buxhetore i kemi ndarë në: Institucione të nivelit qendror (Ministritë, Zyra e Kryeministrit, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana dhe TAMAD¹⁸), Institucione të pavarura¹⁹ dhe Institucione të nivelit komunal (37 Komuna dhe Zyra administrative e Mitrovicës Veriore).

¹⁸ TAMAD është një projekt donator në kuadër të sektorit të bujqësisë, të cilin ZAP e ka audituar sipas marrëveshjes me pagesë.

¹⁹ Në institucionet e pavarura janë përfshirë Kuvendi i Kosovës, Zyra e Presidentit, Agjencioni Kosovar i Privatizimit dhe 25 institucione tjera.

Tabela 8. Zbatimi i rekomandimeve të AP-së, dhënë OB-ve për vitin 2013

Subjektet e audituara	Rekomandimet	Plotësisht të adresuara		Të adresuara (në proces)		Të pa adresuara	
		Nr	Nr	%	Nr	%	Nr
Institucionet e nivelit Qendror	313	98	31	95	30	120	39
Institucionet e pavarura	199	102	51	37	19	60	30
Institucionet e nivelit lokal	521	136	26	172	33	213	41
Totali	1053	336	32	304	29	393	37

Tabela 9: Zbatimi i rekomandimeve të AP-së, dhënë OB-ve për vitin 2012

Subjektet e audituara	Rekomandimet 2012	Plotësisht të adresuara		Të adresuara (në proces)		Të pa adresuara	
		Nr	Nr	%	Nr	%	Nr
Organizatave e nivelit Qendror	200	54	27	100	50	45	23
Organizatave e pavarura	157	86	55	43	27	28	18
Organizatave e nivelit lokal	307	80	26	113	37	113	37
Totali	664	220	33	256	39	186	28

Nga krahasimi ndërmjet vitit 2013 dhe vitit 2012, numri i rekomandimeve është rritur derisa është vërejtur përmirësim i lehtë në dinamikën e implementimit të tyre.

Implementim i rekomandimeve vazhdon të jetë sfidë e vështirë për organizatat e nivelit qendror dhe lokal/komunat. Rekomandimet e paadresuara kanë të bëjnë kryesisht me fushat si: saktësia e shpalosjeve në PVF, planifikimi dhe realizimi i buxhetit menaxhimi i të hyrave, procedurat e prokurimit, klasifikimi i shpenzimeve, subvencionet obligimet e papaguara dhe menaxhimi i regjistrave të pasurisë. Mos adresimi i rekomandimeve të dhëna ka rezultuar në dobësi të vazhdueshme në kontrollin e brendshëm dhe në humbje financiare dhe ka bërë që disa nga rekomandimet që përsëriten.

4.4 REKOMANDIMET

Unë rekomandoj Kuvendin e Kosovës të konsiderojë mundësinë që:

- Qeveria të bëjë identifikimin dhe sqarimin e rrethanave të cilat kanë penguar adresimin e rekomandimeve të mëparshme si dhe të ndërmerr veprime të nevojshme për implementimin efektiv dhe me kohë të tyre;
- Të shqyrtojë arsyet e mos adresimit të rekomandimeve të mëhershme për të gjetur barrierat që kanë shkaktuar përsëritjen e tyre;
- Qeveria do të udhëheqë dhe të koordinojë zhvillimin e një plani veprues për adresimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, dhe të raportojë për progresin e arritur.

Unë poashtu rekomandoj Qeverinë të sigurojë:

- Një analizim efektiv të shkaqeve për nivelin e ulët të zbatimit të rekomandimeve të AP-së nga vitet e kaluara në nivel të RVA-së dhe në nivel të OB-ve individuale, dhe identifikimin dhe ndërmarrjen e masave dhe veprimeve të nevojshme për përmirësimin e këtij niveli;
- Të zbatohet një proces efektiv i monitorimit të zbatimit të planeve të veprimit për implementimin e rekomandimeve të AP-së, nga të gjitha Ministritë, për të mundësuar identifikimin dhe adresimin e barrierave që ndikojnë në implementim të dobët të rekomandimeve; si dhe
- MF kërkon nga OB-të individuale që në draft PVF-ve individuale të vitit 2015 të paraqesin informata për progresin e arritur në adresimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Derisa PVF të OB-ve të cilat nuk përmbajnë informata rreth gjendjes së rekomandimeve apo informatat e prezantuara janë të pamjaftueshme ti kthej mbrapa tek OB-të përkatëse për plotësim.

5. QEVERISJA E MIRË

Konkluzion i përgjithshëm:

Qeveria në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar është angazhuar në drejtim të draftimit të strategjisë së Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (KBFP-së) për sektorin publik dhe zhvillimit të saj të mëtutjeshëm. Kjo shënon një hap pozitiv në avancimin e kornizës që siguron një sistem solid të kontrollit dhe menaxhimit të fondeve publike. Aplikimi i plotësimi online të pyetësorëve të vet-vlerësimit është një tjetër hap pozitiv me efekt lehtësues dhe që ka shërbyer si pikënisje për të përmirësuar performancën organizative. Korniza ligjore dhe institucionale për një qeverisje të mirë ekziston, porse ajo ende nuk ka gjetur zbatim të plotë dhe efektiv në menaxhimin e përditshëm. Zhvillimet politike në gjysmën e dytë të vitit për shkak të ngërçit politik dhe mos konstituimit me kohë të Kuvendit të Kosovës mund të kenë pasur efektin e vet në këtë aspekt.

Praktikat aktuale tregojnë se qeverisja dhe kontrolli nuk janë integruar si duhet në proceset menaxhuese të planifikimit, ekzekutimit dhe monitorimit. Standardet e qeverisjes nuk janë kuptuar sa duhet dhe nuk janë aplikuar nga secili nivel i përgjegjësisë organizative. Me gjithë përpjekjet për avancim, ende ka mangësi të cilat ndikojnë ndjeshëm në funksionimin efektiv të qeverisjes së mirë. Aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes kërkojnë forcim të metejshëm. Mekanizmat e kontrollit mbi të hyrat dhe mbi një numër të fushave të shpenzimeve kërkojnë përmirësim për të parandaluar humbjet financiare, vlërën e uët për para dhe menaxhimin jo efektiv të projekteve dhe pasurisë publike.

5.1 HYRJE

Qeverisja ka të bëjë me sistemin përmes të cilit organizatat menaxhohen dhe kontrollohen. Një qeverisje e mirë kërkon një planifikim real, ekzekutim buxhetor korrekt, aranzhime të monitorimit dhe raportimit të cilat i adresojnë qartë rreziqet operative dhe strategjike me të cilat ballafaqohet organizata.

Qeverisja e mirë mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të kontrolleve dhe menaxhimit financiar dhe operativ duke kontribuar në realizimin e planeve strategjike dhe vjetore dhe arritjen e objektivave të synuara për të mirën e qytetarëve.

Palët e rëndësishme të interesit në këtë kuptim janë:

- Menaxherët të cilët duhet të jenë të përgjegjshëm për mënyrën e menaxhimit të buxhetit,
- Auditorët e brendshëm që do të vlerësojnë përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe rekomandimet për përmirësimet e mundshme; si dhe
- DQH e cila do të monitorojë dhe ofrojë mbështetje për OB për një menaxhim financiar dhe kontroll adekuat.

Në këtë kapitull do të trajtohen çështjet dhe sfidat me të cilat janë ballafaquar institucionet në menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Çështjet e ndërlidhura me blerjet përmes procedurave të prokurimit publik, nuk do të trajtohet në kuadër të këtij kapitulli, pasi kjo do të shtjellohet më në detaje në kapitullin VI - Prokurimi Publik.

5.2 KONTROLLI I BRENDSHËM I FINANCAVE PUBLIKE (KBFP)

KBFP-së ka për qëllim të sigurojë se kontrolli dhe menaxhimi i burimeve dhe pasurive publike bëhet në mënyrë ekonomike, efikase, efektive dhe në pajtueshmëri me kornizën ligjore. Koncepti i KBFP-së karakterizohet nga menaxhimi i fondeve publike bazuar në rrezik, sistemit të kontrollit të brendshëm, llogaridhënien menaxheriale dhe rolit ndihmës të auditimit të brendshëm në përmbushjen e objektivave të institucioneve të sektorit publik.

Ndonëse përmes KBFP-së është siguruar një bazë ligjore dhe organizative, zbatimi në praktikë ka rëndësi të posaqme sidomos kur dihet se buxheti aktual është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat aktuale.

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli si janë aspekte kyçe të KBFP-së të trajtuar më poshtë. Gjithashtu ka detaje për fushat e caktuara ku kërkohen përmirësime të mëtutjeshme nëpër OB-të.

5.3 MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI (MFK)

Është përgjegjësi e menaxhmentit krijimi i një sistemi të mirëfilltë efikas financiar dhe organizativ. Për të arritur këtë, nevojitet strukturë organizative adekuate të cilat përcaktojnë qartë linjat e autoritetit, raportimit dhe përgjegjësi nga secili nivel menaxherial.

Dobësit menaxheriale, financiare dhe të zbatimit të kontrollit të brendshëm të shpalosura në raportet individuale të auditimit për OB-të, tregojnë se koncepti i MFK-së ende nuk është kuptuar sa duhet nga institucionet shtetërore. Se sistemi i MFK-së nuk është edhe aq funksional tregojnë mangësit e hasura si në planifikim dhe ekzekutim të buxhetit, delegim dhe ndarje të detyrave, planifikim dhe inkasim të të hyrave, shpërndarjen e subvencioneve. Mangësitë tjera kanë të bëjnë me planifikim dhe menaxhim të projekteve kapitale, menaxhim të personelit, menaxhim të pasurisë dhe obligimeve, mangësit në raportimin dhe konsolidimin e PVF-ve, mungesë e komunikimit mes agjencioneve dhe departamenteve, raportimi jo efektive menaxherial, si dhe niveli i ulët i adresimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Shumica e OB-ve nuk kanë udhëzime të brendshme apo procedura operative të detajuara që mbulojnë aktivitetet e përditshme të ndërlidhura me MFK-në.

Raportimet e dobëta menaxheriale pamundësojnë vendim-marrjen dhe reagimin me kohë të menxhmentit në adresimin e dobësive dhe përmirësimet e nevojshme.

Raportimi i brendshëm efektiv për menaxhmentin është një bazë e mirë për monitorimin dhe zgjerimin e kontroleve menaxheriale për të përmirësuar qeverisjen.

Sfidë e OB edhe më tutje vazhdon të jetë menaxhimi i rrezikut, kjo si një komponent kyçe e MFK-së. OB, në përgjithësi, nuk kanë procedura të dokumentuara në menaxhimin e rrezikut, nuk identifikojnë, analizojnë, vlerësojnë dhe as nuk ndërmarrin veprime për të menaxhuar rreziqet në arritjen e objektivave të tyre deri në nivel të pranueshëm.

Ndonëse ka filluar të kuptohet roli dhe rëndësia e vet-vlerësimit të organizatës nga menaxhmenti, ky obligimi ligjor nuk është përmbushur nga të gjitha OB-të, e sidomos nga niveli komunal.

Numri i pyetësorëve të kompletuar online është rritur (vetëm një ministri, katër institucione të pavaruara dhe dymbëdhjetë komuna nuk i kanë dorëzuar vet-vlerësimet në MF). Sidoqoftë, cilësia e informacionit që pyetësorët përmbajnë mbetet të avancohet tutje. Në shumicën e rasteve notimi i pyetjeve është mbivlerësuar nga menaxherët. Vet-vlerësimi nuk ishte mjaft vet-kritik nga menaxhmenti dhe cilësia dhe objektiviteti i procesit ishin të pamjaftueshme.

Menaxherët duhet të zhvillojnë më tutje sistemin e raportimit financiar, të identifikojnë dhe menaxhojnë rreziqet potenciale, të ngritin cilësinë e raportimit të brendshëm brenda organizatës dhe të ndërmarrin veprimet të duhura dhe në kohë për adresimin e çështjeve të raportuara. Një kontroll i brendshëm efikas duhet të sigurojë efektivitet dhe efikasitet të veprimeve operationale të cilat gjithashtu duhet të jenë në përputhshmëri me ligjet dhe rregulloret, por edhe raportim financiar cilësor e të saktë.

Me gjithë mbështetjen në zbatimin praktik të MFK-së dhe organizimit të trajnimeve për zyrtarët financiar dhe auditorët e brendshëm, Departamenti Qendror Harmonizues (DQH) duhet edhe më tej të zhvillojë programe mbështetëse profesionale për OB-të, dhe të monitorojë qasjen dhe zbatimin e kërkesave të MFK-së dhe aktivitetet e AB-së.

Sidoqoftë, ia vlen të përmendet se gjatë vitit 2015 MF ka organizuar një konferencë për udhëheqësit e lartë të OB-ve për ngritjen e vetëdijes lidhur me përgjegjësitë menaxheriale për zbatimin e KBFP-së.

5.4 AUDITIMI I BRENDSHËM

Auditimi i Brendshëm (AB) ka rol dhe kontribut të rëndësishëm në qeverisjen e mirë në sektorin publik. Zhvillimi i sistemit të auditimit të brendshëm është duke shkuar në drejtimin e duhur porse ende ka mundësi për avancim. Përparimet janë më të dukshme në institucionet e sektorit qendror në krahasim me atë lokal.

Ndonëse obligim ligjor, nëntë OB ende nuk kanë krijuar. Ndërsa në komunën e Obiliqit dhe atë të Leposaviqit NjAB-të nuk ishin funksionale. Në nivelin qendror, e kryesisht në IP, por edhe në pesë komuna, NjAB-të nuk kanë numrin e duhur të auditorëve në raport me buxhetin dhe nevojat e tyre për të përmbushur programet vjetore dhe për të siguruar menaxhmentin për funksionalitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Kufizimet buxhetore kanë ndikuar që një numër i OB të mos kenë numrin e nevojshëm të AB, e kjo kushtimisht ka limituar planet e auditimit të jenë më gjithëpërfshirëse.

Po ashtu kemi IP që plotësojnë kriterin për të formuar NjAB sipas buxhetit vjetor, por që janë shumë të vogla për nga aspekti organizativ dhe i personelit. Kjo shfaq nevojën për rishqyrtim të kriterëve për themelimin e NjAB-ve me qëllim që të ketë një barazpeshë midis kostos dhe përfitimit nga krijimi i tyre. Departamenti i Auditimit të Brendshëm (DAB) që vepron në kuadër të MF-së ka ofruar shërbime të auditimit të brendshëm për gjashtë IP, por disa kërkesa tjera kishin mbetur pa u plotësuar.

Planet e auditimit të disa NjAB-ve nuk ishin të drejtuara sa duhet kah adresimi i rreziqeve, ishin më shumë të përqendruara në pajtueshmëri e me pak ndaj ndryshimeve dhe përmirësimeve të sistemit. Mangësi të tjera të cilat karakterizonin punën e NjAB në disa komuna ka të bëjë me mospërputhjet e aktivitetëve me planin e punës dhe përfundimisht kualitet i dobët i raporteve të auditimit.

Komiteti i Auditimit (KA) është organ që përkrahë pavarësinë e NjAB-ve derisa sfidon planet e tyre dhe siguron se ato e ndihmojnë menaxhmentin e organizatës në mënyrë efektive. Sidoqoftë

- rreth 20% e KA në nivelin qendror nuk janë efektive;
- në një ministri dhe në pesëmbëdhjetë komuna KA nuk është themeluar ende, ndërsa në gjashtë të tjera ndonëse i themeluar është jofunksional;
- aty ku KA janë funksionale efekti i aktivitetit të tyre është i diskutueshëm pasi që nuk i kryejnë detyrat e tyre ashtu siç kërkohet; si dhe
- në shumicën e rasteve, anëtarët e KA nuk kanë përvojën dhe kualifikimet e nevojshme profesionale në fushën e financave dhe auditimit.

Sfidë kryesore mbetet zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Një proces i tillë kishte dështuar në gjysmën e komunave duke lënë hapsirë diskutimi për efektivitetin e ekipeve të auditimit të brendshëm dhe KA.

5.5 INDIKATORËT E PERFORMANCËS NË NIVELIN KOMUNAL

Edhe këtë vit ne analizuam indikatorët kyç me qëllim të inicimit të diskutimeve lidhur me cilësinë e shërbimeve të ofruara nga Komunitat²⁰. Fokus i krahasimeve ishin: realizimi i buxhetit për investime kapitale, të hyrat, shpenzimet e reprezentacionit dhe derivateve, shqyrtimi i aplikacioneve për leje ndërtimi, si dhe fusha e arsimit dhe shëndetësisë.

Konkluzionet janë si vijon:

- Në të gjitha fushat e indikatorëve janë vërejtur variacione të konsiderueshme madje edhe në komunitat me madhësi të përafërt;
- Komunitat kanë tendencë që të shfrytëzojnë maksimalisht fondet nga granti qeveritar, derisa pjesë e konsiderueshme e të hyrave vetanake barten në vitet vijuese;
- Ekzistojnë dallime domethënëse në mes inkasimit të të hyrave vetanake dhe shfrytëzimit apo destinimit të atyre fondeve në projekte kapitale, me ndikim përmirësimin e standartit jetësor të taksapaguesve;
- Planifikimi i të hyrave vetanake bëhet pa mbështetje në analiza të trendeve dhe potencialit të mirëfilltë për gjenerimin e të hyrave. Shpesh herë kjo rezulton me tejkalim të planit inkasues. Tejkallim i inkasimeve apo nënvlerësim dhe planifikim jo real i të hyrave nga tatimi në pronë kemi në Komunitat Prishtinë, Lipjan, Malishevë, Kllokot dhe Shtërpçë;
- Performancë e dobët në administrimin dhe inkasimin e llogarive të arkëtueshme. Balanca e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2014 ishte 153,721,177€, apo 4% më shumë se vitin e kaluar që ishte 147,199,083€;
- Shifër shqetësuese e hyrjes në obligime financiare dhe bartjes së tyre ndër vite, sidomos te komunitat: Shtërpçë, Kllokot, Gjakovë, Gjilan dhe Lipjan. Detyrimet e përgjithshme financiare të të gjitha komunave në fund të vitit ishin 13,271,569€;

²⁰ Në këtë analizë nuk janë përfshirë Komunitat: Mitrovica Veriore, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan.

- Shpenzimet vjetore të drekeve zyrtare për 34 komuna ishin 734,894€. Për shpenzimet më të larta kryesojnë Shtërpca, Kllokoti, Mamusha, Han i Elezit, Graçanica, Klina, Prizreni, Shtime, Juniku, Gjakova, Kamenica, Deçani dhe Gjilani;
- Komunitet me shpenzimet për dreka më të larta krahasuar me shpenzimet e tërësishme ishin tek Komunitet: Shtërpca, Kllokot, Mamushë, Han i Elezit, Graçanicë, Klinë, Prizren, Shtime, Junik, Gjakovë, Kamenicë, Deçan dhe Gjilan; dhe se
- Komunitet Graçanicë, Prishtinë, Kaçanik, Prizren, Pejë dhe Suharekë në masë të madhe nuk kanë shqyrtuar në kohë aplikacionet për leje ndërtimi.

5.6 SISTEMI I SHËRBIMIT CIVIL

Shërbimi Civil (ShC) është një prej komponentëve kyç të administratës publike. Reforma e ShC është e gjërë, komplekse dhe e përcjellë nga sfida të shumta. SHC në Kosovë përbën diku rreth 19.000 nëpunës të cilët janë të shpërndarë në të gjitha institucionet e administratës publike në nivelin lokal dhe qendror. Në vitin 2014, reforma në shërbimin civil nuk ka shënuar ndonjë progres të theksuar për shkak të ngërçit politik. Gjatë vitit 2015 kishte disa zhvillime pozitive në procesin e reformimit të shërbimit civil, si:

- Hartimi i draft strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020 dhe Planin e saj të Veprimit 2015-2017. Draft Strategjia përfshinë objektiva, synime dhe indikatorë të qartë të performancës, dhe se është bërë kostimi i veprimeve në mënyrë të qartë dhe sipas planit të veprimit;
- Ka filluar së funksionuari sistemi i vlerësimit të performancës;
- Ka nisur implementimi i Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ);
- Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) ka ofruar trajnimet e nevojshme për personelin e SHC; dhe se
- Është finalizuar dhe aprovuar Ligji për Procedurat Administrative.

Sfidë kryesore e Qeverisë vazhdon të mbetet implementimi i akteve nënligjore që derivojnë nga Ligji për Shërbimin Civil dhe Ligji për Pagat e Nëpunësve Civilë. Sfidat kryesore në këtë drejtim janë:

- Vonesat në zbatimin e sistemit²¹ të klasifikimit të vendeve të punës dhe sistemit të ri të pagave. Zbatimi i sistemit të ri të pagave varet nga zbatimi i katalogut të vendeve të punës, të klasifikimit të vendeve të punës dhe vlerësimi i performancës në punë, implementimi i së cilave është parakusht i zbatimit efikas të sistemit të pagave;
- Vonesat në funksionalizimin e sistemit të menaxhimit të informatave në SHC dhe sistemi i dobët i monitorimit të zbatimit të legjislacionit relevant;

²¹ Ky sistem është dizajnuar sipas Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, i miratuar në vitin 2010, si dhe Rregulloren për Klasifikimin e Vendeve të Punës në SHC, i miratuar në vitin 2012.

- Procesi i rekrutimit dhe avancimit në SHC dhe pamundësia e implementimit të plotë të parimeve për një shërbim civil jo-politik, të rekrutimit sipas meritës, si dhe ngritjes së profesionalizimit;
- Mungesa e një qasje strategjike në zhvillimin e SHC dhe zhvillimi i trajnimeve pa u bazuar në nevojat e SHC; dhe
- Sistemi jo i qartë i llogaridhënies, mungesë e zbatimit të parimeve të kodit të etikës në SHC.²²

Organizimi dhe pagesa e pagave në sektorin publik bëhet përmes një sistemi të centralizuar i cili nga viti 2015 menaxhohet nga MF/Thesari. Paga e nëpunësve civilë përfshinë pagën bazë dhe shtesat. Këto dhe kompensimet tjera financohen nga fondi i përgjithshëm buxhetor, por edhe nga fondet e donatorëve.

Raportet individuale të auditimit të OB-ve tregojnë se ka mangësi sa i përket menaxhimit dhe kontrolleve në këtë fushë, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me:

- Mos respektimi i kriterëve të konkursit publik gjatë rekrutimit të stafit;
- Avancimi në karriera pa procedura të avancimit;
- Pagesën e pagave shtesë pa aprovim paraprak dhe pa dëshmi përkatëse për punë shtesë;
- Pozita të mbajtura nga ushtrues detyre përtej afatit kohor ligjor; dhe
- Mos azhurnimi i dosjeve të personelit.

5.7 SISTEMI I MENAXHIMIT TË PASURISË

Pasuritë publike kanë rëndësi domethënëse në fuqizimin e institucioneve, gjenerimin e të hyrave vetanake dhe shërbimet e ofruara për qytetarët. Pasuritë si pronë publike kërkojnë menaxhim adekuat, përfshirë pranimin, regjistrimin, mirëmbajtjen, ruajtjen, identifikimin dhe raportimin e tyre.

Menaxhimi i pasurisë publike vazhdon të përcillet me mangësi, duke filluar që nga regjistrimi, menaxhimi i përditshëm dhe raportimi financiar i saj. Ende nuk ekziston një përkushtim dhe gatishmëri e maxhmentit për të përmirësuar mangësit aktuale dhe për avancuar në një sistem të mirëfilltë të menaxhimit të pasurisë publike.

Aktualisht regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë publike, siç edhe kërkohet me rregullën në fuqi, bëhet përmes SIMFK-së dhe e-pasurisë, përkatësisht në dy databaza të ndryshme. E meta kësaj, është se këto dy sisteme ende nuk bashkëveprojnë njëra me tjetrën. Përveç tyre, disa prej OB posedojnë edhe programe të veçanta të regjistrimit të pasurisë, duke krijuar kështu një databazë të tretë të të dhënave. Kjo situatë shkakton paqartësi dhe pasiguri për plotësin dhe saktësin e informacionit rreth pasurisë, e cila negativisht po reflektohet si në menaxhimin e saj, ashtu edhe në shpalosjen e vlerës së pasurisë në PVF-të e institucioneve buxhetore.

Dobësitë sistematike në menaxhimin e pasurisë janë hasur si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Në katër komuna nuk ishin raportuar pasuritë kapitale, në dhjetë komuna nuk janë raportuar pasuritë jo-kapitale, dhe në gjashtëmbëdhjetë komuna nuk janë raportuar fare stoqet.

²² Kjo sfidë elaborohet nën kapitullin që lidhet me organizimin e administratës publike dhe llogaridhënien

Probleme janë hasur edhe në njehësimin fizik dhe vlerësimin e pasurisë. Inventarizimi i pasurisë nuk ishte bërë në 18 organizata të nivelit lokal dhe në 10 të nivelit qendror. Mangësi janë hasur në regjistrim, në kategorizimin e tyre, zhvlerësim, tjetërsim, klasifikim jo të drejtë të investimeve në vijim, dhe mos kthim të pajisjeve pas përfundimit të punës apo mandatit të zyrtarëve.

Për shkak të mungesës së një menaxhimi sistematik të pasurive dhe dobësive të përshkruara më lartë, për 8 komuna është dhënë opinion i kualifikuar ndërsa për 27 të tjera opinionet ishin me theksim të çëshjtes. Vetëm Komuna e Hanit të Elezit ka marrë Opinion të Pamodifikuar.

Rregulla aktuale për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare ka mundësuar një bazë të mirë ligjore, porse e njëjta nuk ka qartësuar aq sa duhet mënyrën e regjistrimit dhe menaxhimit të pasurisë përmes sistemit e-pasuria. Një grup punes ndërministror është duke punuar për të plotësuar dhe avancuar këtë rregullore si dhe programin e-pasuria me qëllim përmbushjen e nevojave dhe kërkesave të OB-ve. Mënyra e përdorimit të këtyre sistemeve duhet të përcaktohet me manualët për përdorimin e tyre.

E-pasuria më së paku ka gjetur zbatim nga komunat, ku në 20 prej tyre ky sistem nuk përdoret fare, ndërsa pjesa tjetër e komunave kanë vështirësi për të aplikuar këtë program. Vështirësi në aplikim të e-pasurisë kishte edhe në 13 OB të nivelit qendror. Kjo për shkak të mungesës së shkathtësive nga stafi përgjegjës, por edhe trajnimeve të pamjaftueshme në përdorimin e saj.

Mangësit teknike të hasura dhe të raportuara viteve paraprake rreth funksionimit të web aplikacionit e-pasuria tashmë pothuajse janë evituar nga Agjencioni i Shoqërisë së Informacionit (ASHI në kuadër të MAP) si bartës i këtij projekti dhe kompanisë projektuese/mbikqyrëse.

5.8 MENAXHIMI I AUTOMJETEVE ZYRTARE

Kategori e veçantë e pasurisë kapitale janë edhe automjetet qeveritare, të cilat shërbejnë për kryerjen e detyrave zyrtare. Rregulla përkatëse në fuqi kërkon që përdoruesit e tyre duhet t'i shfrytëzojnë ato në mënyrë sa më efikase dhe ekonomike. Përgjegjëse për përdorimin dhe kontrollimin e automjeteve është njësia e transportit e organizatës përkatëse.

Keqpërdorimet e evidentuara në raportet individuale të auditimit tregojnë se shpeshherë gjatë përdorimit të automjeteve shmangen procedurat dhe kërkesat ligjore. Një numër i konsiderueshëm i veturave zyrtare shfrytëzohet nga stafi politik dhe menaxherial, dhe për më tepër ata nuk mbajnë fare shënime rreth përdorimit të tyre. Përdorimi i automjeteve zyrtare pas orarit të rregullt të punës vazhdon si rezultat i kontrolleve të pamjaftueshme dhe jo funksionale në shumë OB. Me gjithë regulat dhe kërkesat qeveritare për ndaljen e keqpërdorimeve të automjeteve nuk duket se ka ndryshuar diçka në këtë drejtim.

Mangësit më të theksuar përfshirë ato rreth mirëmbajtjes dhe riparimit të veturave hasen te organizatat që kanë në posedim numër më të madh të automjeteve. Për shkak të menaxhimit jo të mirë në Ministrinë e Punëve të Brendshme 268 automjete presin për servisim qysh para vitit 2009. Në raportet e auditimit të viteve të kaluara, është përmendur mungesa e raportimeve nga OB-të në Njësinë për Monitorimin dhe Përdorimin e Autromjeteve Qeveritare (NjMPAQ)²³ që ka për qëllim raportimin rreth shfrytëzimit të automjeteve zyrtare.

²³ UA 03/2008 obligon të gjitha institucionet qeveritare të raportojnë në NjMPAQ në baza mujore për numrin, përdorimin dhe menaxhimin e automjeteve qeveritare.

Një situatë e tillë vetëm sa është përkeqësuar. Raportimi mujor i OB-ve në NjMPAQ gjatë vitit 2014 kishte rënie të vazhdueshme. Në fillim të vitit kishin raportuar 17 OB, ndërsa deri në fund të vitit kishin raportuar vetëm pesë OB.

5.9 TRAJTIMI I LEGJISLACIONIT SEKONNDAR

Përpos legjislacionit primar, aktivitetet operative dhe financiare të OB-ve janë të rregulluara edhe përmes legjislacionit sekondar. Këto rregulla të përgjithshme të Qeverisë vazhdojnë të zbatohen pa ndonjë ndryshim apo plotësim eventual me qëllim të përshtatjes së rrethanave aktuale. Në po i nxjerrim në pah, vetëm tre Udhëzime Administrative (UA) të përgjithshme të Qeverisë të cilat kërkojnë azhurim:

- UA nr. MSHP 2004/07 Për Udhëtimet Zyrtare, i aprovuar në vitin 2004. Sipas këtij UA, tarifat e mëditjeve ditore për udhëtimet zyrtare në shtetet fqinje janë mbivlerësuar në krahasim me koston e jetesës së këtyre shteteve. Qëllimi i udhëtimit, agjendës dhe nivelit të takimeve zyrtare jashtë vendit duhet të jenë temat prioritare për trajtim. OB shpeshë herë organizojnë seminare, trajnime apo grupe punuese jashtë vendit, me qëllim përfitimin e mëditjeve mjaft të larta për stafin;
- UA nr. 04/2008 për përdorimin e telefonave (fiks dhe mobil) në Qeverinë e Kosovës, i aprovuar në fillim të vitit 2008. Me këtë UA janë përcaktuar limitet²⁴ e shpenzimeve mujore sipas secilit nivel të përgjegjësive. Aplikimi i mëtejshëm i limiteve të shpenzimeve të përcaktuara me këtë UA, apo shfrytëzimi i mëtejshëm i shërbimeve mobile me parapagim nuk është i justifikueshëm duke pas parasysh zhvillimet e teknologjisë; si dhe
- UA nr. 03/2008 për Përdorimin e Automjeteve Qeveritare, i aprovuar në fillim të vitit 2008. Dobësit e hasura në përdorimin, menaxhimin dhe raportimin e shfrytëzimit të automjeteve zyrtare, vënë në pah nevojën për plotësimin apo hartimin e një udhëzimi të ri me gjithëpërfshirës dhe me kërkesa shtesë.

5.10 REKOMANDIMET

Rekomandojmë Qeverinë që të sigurojë se:

- Veprimet e ndërmarra deri më tani do të vazhdojnë më tutje sa i përket forcimit të vetëdijës dhe përgjegjësisë menaxheriale për zbatimin efektiv të KBFP-së përfshirë procedurat e MFK-së, rolin AB-së si dhe kontributin potencial të komiteteve të auditimit në zhvillimin e sistemeve dhe të proceseve. Në këtë aspekt adresimi i rekomandimeve të AB-së duhet të trajtohet me prioritet;
- Menaxherët e OB-ve sigurojnë implementimin efektiv të kërkesave bazike të MFK-së lidhur me vetëvlerësimin, menaxhimin e rrezikut, raportimin e brendshëm (financiar dhe operativ) si dhe sistemin e auditimit të brendshëm. Trajnimi i tyre në këto fusha do të ishte i dobishëm;

²⁴ Për shembull, sipas UA. Nr. 04/2008, drejtorëve të departamentëve u takon 40€ mbushje telefonike në muaj.

- Janë analizuar dobësit e në raportet individuale të auditimit dhe të ndërmarrë veprime korigjuese në forcimin e mëtejme të sistemit të MFK-së dhe llogaridhënies publike. Planet e veprimit duhet të përcaktojnë prioritetet dhe afatin kohor për përmirësime;
- Janë analizuar çështjet e ngritura në këtë raport lidhur me qeverisjen e mirë si dhe të identifikojë veprimet që nevojiten për të adresuar me kohë dobësitë aktuale dhe barrierat e mundshme;
- DQH vazhdon të mbështesë dhe monitorojë zbatimin e kërkesave të MFK-së dhe implementimin e sistemit të auditimit të brendshëm nëpër OB;
- DQH vazhdon mbajtjen e kontakteve me menaxherët e OB-ve me qëllim të prezentimit të rëndësisë dhe rolit që ka procesi i vet-vlerësimit;
- OB zhvillojnë dhe zbatojnë politika dhe plane konkrete të identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve si dhe format e reagimit ndaj tyre, duke përmirësuar kështu gjasën e përmbushjes së misionit dhe objektivave të organizatës;
- OB hartojnë rregulla, udhëzime dhe procedura të brendshme të shkruara që rregullojnë aktivitetet e përditshme operative dhe financiare;
- Menaxhmenti i OB zhvillon dhe të mbështetet në komunikimin formal. Vëmendje e veçantë t'i kushtohet formës dhe kualitetit të raportimit të brendshëm, për të krijuar një bazë të mirë për monitorim sistematik dhe cilësi në aktivitetet operacionale;
- Reformat në shërbimin civil dhe në funksionalizimin e sistemit të ri të pagave të përmbushen në afatin sa më të shkurtë. Është shtuar niveli i kontrollit dhe transparencës në procedurat të rekrutimit dhe pagesës së kompenzimeve shtesë;
- Inicohet një vlerësim gjithëpërfshirës mbi arsyet e theksimit të çështjes së opinioneve të auditimit nga mungesa e regjistrave dhe raportimit të pasaktë të pasurisë, dhe të sigurojë që një zgjidhje efektive është zbatuar deri në fund të vitit 2015;
- OB, e në veçanti Komunitat, duhet të vlerësojnë shkathtësitë e stafit për menaxhim të pasurisë dhe të ofrojnë trajnime praktike, për të siguruar se ata e kuptojnë rëndësinë e një menaxhimi të mirëfilltë të pasurive dhe rolin e tyre në këtë proces;
- Programi e-pasuria të implementohet në të gjitha institucionet shtetërore. Të shqyrtohen dobësitë prezente dhe të zbatohen kontrole të shtuara që sigurojnë regjistrim të plotë dhe menaxhim adekuat të pasurisë. MAP dhe MF duhet të gjejnë një zgjidhje praktike të bashkëveprimit në mes sistemit të SIMFK-së dhe e-pasurisë;
- Zbatohet një proces efektiv i menaxhimit të automjeteve të gjitha OB-të, duke siguruar monitorim të vazhdueshëm dhe veprim me kohë ndaj faktorëve dhe barrierave ekzistuese që pengojnë zbatim e kërkesave ligjore; dhe
- Rregullat apo Udhëzimet Administrative, zbatimi i të cilave shkakton kosto financiare të paarsyeshme ose nuk rregullojnë si duhet çështje të caktuara operative dhe të kontrollit, të ndryshohen ose hartohen rregulla të reja.

Rekomandojmë Kuvendin që të sigurojë se:

- Qeveria do të trajtoj me prioritet zbatimin efektiv të kërkesave të MFK-së të dalura nga strategjia e re e KBFP-së si dhe funksionimin efektiv të NjAB-ve dhe Komiteteve të Auditimit përgjatë organizatave buxhetore;
- Qeveria do të ndërmarrë veprime konkrete në adresimin e mangësive në menaxhimin e pasurisë. Çështja e unifikimit të dy sistemeve, të SIMFK-së dhe e-pasurisë, të trajtohet me prioritet nga MF dhe MAP; dhe
- Është gjetur një zgjidhje e qëndrueshme e organizimit të përbashkët institucional të auditimit të brendshëm për të ofruar shërbime të auditimit për IP-të, në veçanti për ato që karakterizohen me personel dhe buxhet të ulët.

6. PROKURIMI

Konkluzion i përgjithshëm:

Prokurimi publik ka shënuar një progres të kufizuar me mangësi të përsëritura edhe këtë vit në të gjitha fazat e tij dhe përmirësimi i sistemit të prokurimit vazhdon të jetë sfidë për Qeverinë/ Kuvendin e Kosovës edhe në të ardhmen.

Raportet e auditimeve të rregullsisë në të gjitha nivelet e veçanërisht në nivelin lokal (Komuna) kanë evidentuar mangësi në zbatimin e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP). Kjo tregon se menaxhmenti i OB-ve ende nuk ka arritur ti tejkaloj sfidat për të bërë që ky sistem të funksionojë më mirë.

Mos përgatitja e mirë e procesit të prokurimit, dobësitë në zhvillimin e procesit si dhe mangësitë në menaxhimin e kontratave janë tregues se prokurimi në OB kërkon adresim të problemeve të identifikuara dhe përmirësim në mbarëvajtjen e këtij procesi.

Përmirësime priten pas ndryshimit të LPP-së dhe me futjen në përdorim të prokurimit elektronik si dhe fillimin e zbatimit të kontratave të centralizuara nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).

6.1 HYRJE

Në vitin 2014 institucionet publike përmes procesit të Prokurimit kanë shpenzuar rreth 488 milionë euro, apo rreth 33% të shpenzimeve të Buxhetit të Kosovës. Kjo tregon ndikimin e madh që do të kishte mbarëvajtja efektive e procesit të prokurimit në zhvillimin e ekonomisë vendore.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) gjatë vitit 2014, ka filluar të zhvilloj platformën e prokurimit elektronik. Ky projekt financohet nga Banka Botërore, dhe zbatimi i projektit ka filluar më 15 Dhjetor 2014. Zhvillimi i plotë i platformës së prokurimit elektronik parashihet të zgjatë një vit dhe synimi është të ndikojë që prokurimet e ardhshme të jenë efektive dhe transparente.

6.2 ROLI I ORGANIZATAVE PËRGJEGJËSE PËR PROKURIM KRPP / OSHP DHE AQP

Organizatave përgjegjëse për funksionimin e prokurimit publik janë KRPP, AQP dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP).

KRPP, është agjenci e pavarur rregullatore dhe përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik. Sipas raportit të KRPP-së vlera e kontratave të nënshkruara në vitin 2014 ishte rreth 390 milionë euro, duke mos përfshirë vlerën e kontratës së autostradës Prishtinë - Han i Elezit. Ky raport pasqyron të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2014 në Kosovë, duke i krahasuar me vitet paraprake, me ç'rast do ta shohim trendin e zhvillimit të Prokurimit Publik në Kosovë.

KRPP thekson se në dy pika ka arritur të përmirësojë për 90% sistemin e prokurimit publik duke eliminuar vendosjen e kriterëve diskriminues në Njoftimet për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. KRPP propozon se për të qenë ky sistem i prokurimit i qëndrueshëm duhet të bëhet amandamenti i LPP-së, për këtë qëllim ajo ka hartuar një varg të udhëzimeve me qëllim të specifikimit të LPP-së.

AQP, vepron në kuadër të MF-së dhe është përgjegjëse për zhvillimin e prokurimeve të përbashkëta për AK-të, zhvillimin e prokurimeve me kërkesën e AK-ve dhe ndihmon në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit për AK-të.

AQP në 2014 ka identifikuar shtatë artikujt e përdorimit të përbashkët nga AK, e cila listë²⁵ është dashur që ti propozohet Qeverisë për miratim nga Ministri i Financave, gjë që nuk ka ndodhur ende. Me miratimin e kësaj liste dhe zhvillimin e procedurave të centralizuara do të arrihet ekonomia e shkallës dhe kursehet në kosto. Aktualisht AQP është në proces të prokurimit të parë të centralizuar, "Shërbime të Transportit Ajrorë" i cili nëse përfundohet përshinë 84 AK.

Një AK mund të caktojë AQP-në për kryerjen e një aktiviteti prokurimi në emër të tij. Në lidhje me këtë, në kuadër AQP-së funksionon drejtorja e prokurimeve të veçanta e cila ka zhvilluar tetë²⁶ aktivitete të prokurimit, me vlerë totale 15,046,190€.

OSHP, është agjenci e pavarur dhe është përgjegjëse për zbatimin e procedurave dhe shqyrtimin e ankesave në prokurim. Gjatë vitit 2014 nga 537 ankesa të pranuar ka shqyrtuar 519 sosh.

OSHP funksionon përmes bordit të saj të cilit i kishte skaduar mandati në muajin gusht 2013 dhe nuk kishte qenë funksional deri në mars 2014. Në mungesë të bordit për një periudhë 8 mujore ankesat e OE nuk ishin shqyrtuar, dhe kjo ka shkaktuar një vakum në trajtimin e ankesave.

Edhe gjatë vitit 2014 OSHP-ja, ka konstatuar dhe vërtetuar se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit nga ana e AK-ve nuk janë respektuar dispozitat e LPP-së dhe të legjislacionit sekondar të prokurimit publik.

6.3 SISTEMI I PIP

Sistemi i Programit për Investime Publike (PIP) është duke u shfrytëzuar nga të gjitha Organizatat Buxhetore, si të nivelit qendror ashtu edhe të atij lokal dhe kjo mundëson që të ketë një menaxhim më të mirë dhe transparencë më të madhe të procesit buxhetor dhe ekzekutimit të projekteve.

OB-të janë deklaruar se Projektet kapitale janë duke u realizuar ashtu siç Kuvendi i ka aprovuar me Ligjin e buxhetit.

Në vitin 2014 shuma e investimeve të menaxhuara përmes sistemit të PIP-it, në nivelin qendror ishte 401 milionë euro, ndërsa në nivelin lokal ishte 129 milionë euro.

PIP është zhvilluar që të rregulloj procesin për menaxhimin e projekteve kapitale. Ky sistem përfshinë procesin e përgatitjes së buxhetit dhe monitorimit të projekteve publike, të cilat ngritin efikasitetin e sistemit në tërësi.

²⁵ Derivate, Material Zyre, Prokurime të TI-se, Produkte Hixhenike, Prokurim i Automjeteve, Prokurim i Ushqimit dhe shërbimeve të Telekomunikimeve.

²⁶ Furnizim me karburante, me material hixhenik, me material zyrtar, me toner, me flamuj, si dhe sigurimi i automjeteve dhe sigurimi fizik i objekteve të MPMS.

6.4 TË GJETURAT NË PROKURIM

Raportet individuale të auditimit të vitit 2014, tregojnë se OB-të akoma kanë mangësi në menaxhimin e proceseve të prokurimit. Përkundër rekomandimeve në raportin vjetor të auditimit për vitin 2013 proceset nuk janë zhvilluar në pajtim të plotë me kornizën e LPP-së.

Sfida të ndryshme janë vërejtur në tërë procesin duke filluar nga planifikimi e deri te realizimi i projekteve. Këto mund të qojnë në një situatë ku do të prokuroheshin mallra & shërbime dhe projekte kapitale të cilësisë jo të duhur dhe me kosto më të lartë.

Ne anën tjetër Qeveria po bën përpjekje për të rritur transparencën duke filluar me prokurimin elektronik, përmes të cilit do të kryhen të gjitha fazat e procesit e prokurimit.

6.4.1 TË GJETURAT NË INSTITUCIONET E NIVELIT QENDROR

Bazuar në raportet individuale për institucionet e nivelit qendrorë vërehet se të gjeturat që janë përsëritur më shpesh janë:

- Planifikim i dobët i prokurimit;
- Mangësi në përgatitjen e dosjes së tenderit;
- Gjatë ekzekutimit të pagesave kishte shmangieje apo devijime nga procedurat e thesarit;
- Ndarje e tenderëve me qëllim të shmangies së procedurave të hapura të prokurimit;
- Dobësi në vlerësimin e tenderëve;
- Vonesë në realizimin e projekteve, dhe
- Mangësi në udhëheqjen e procedurave të prokurimit me rastin e bashkëfinancimeve.

6.4.2 TË GJETURAT NË INSTITUCIONET E NIVELIT LOKAL

Dobësitë më të shpeshta të identifikuara në prokurim gjatë vitit 2014 në komuna janë:

- Vlerësim i dobët i nevojave dhe përgatitje e dobët e paramasave dhe paralogarive;
- Mungesë e planeve të prokurimit (komunat e Kosovës Veriore);
- Planifikimi dhe menaxhimi i dobët i prokurimit dhe praktika e lidhjes së kontratave në fund të vitit;
- Mungesë e projekteve para fillimit të procedurave të prokurimit për ekzekutim të punëve dhe mungesë e planeve për menaxhimin e kontratave;
- Hyrja në kontrata jashtë planit të prokurimit si dhe pa procedura të prokurimit;
- Lidhja e kontratave me çmime jo normalisht të ulëta, apo me çmime të larta krahasuar me vlerën e tregut;
- Ndarje e tenderëve me qëllim të shmangies së procedurave të hapura të prokurimit;
- Vonesa në ekzekutimin e punëve dhe mungesë e aplikimit të ndëshkimeve;
- Anashkalimi i kritereve të dosjes së tenderit;
- Përshtatje e kritereve të tenderit duke favorizuar operatorë të caktuar; dhe
- Pagesa pa përfundim të punëve dhe me situacione të paqarta.

6.4.3 TË GJETURAT NË INSTITUCIONET E PAVARURA

Bazuar në raportet individuale dobësitë më të shpeshta të identifikuar në prokurim gjatë vitit 2014 në institucionet e pavarura janë:

- Planifikimi i dobët i prokurimit;
- Lidhja e kontratave pa zotim të plotë të mjeteve;
- Procesimi i Urdhërblereve pas pranimi të faturës;
- Dobësi në proceset e pranimi të mallrave dhe shërbimeve, dhe
- Lidhja e kontratave me çmime jo normalisht të ulëta.

6.5 VLERA PËR PARA NË PROKURIM

ZAP ka kryer dy auditime të performancës në fushën e prokurimit nga të cilat kemi konstatuar se institucionet nuk janë efektive dhe ekonomike gjatë zhvillimit të procesit të prokurimit.

Përmes auditimit të performancës *“Sistemi i prokurimit në sektorin shëndetësor”* është vlerësuar nëse prokurimi në sektorin shëndetësor ka funksionuar në mënyrë efektive.

Ne konstatuam se ministria e shëndetësisë nuk posedon një strategji të shkruar për prokurim, nuk kishte bërë një vlerësim të duhur të nevojave, nuk kishte menaxhuar kontratat në mënyrë efektive, si dhe nuk ishin zbatuar rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Përmes auditimit të performancës *“Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve zyrtare”* është vlerësuar nëse prokurimi në sektorin publik ka operuar në mënyrë ekonomike.

Është evidentuar se asnjëra nga OB-të e audituara nuk e kishte bërë identifikimin dhe vlerësimin e nevojave, shumica e kontratave nuk ishin ekonomike, si dhe vlera e riparimit ishte më e lartë në krahasim me vlerën e mbetur.

6.6 REKOMANDIMET

Rekomandojmë Qeverinë që të sigurojë se:

- Përmes MF, Qeveria të miratoj listën për artikujt të cilët do të blihen përmes prokurimit të centralizuar dhe që Agjencia Qendrore e Prokurimit të zhvillojë ato procedura në mënyrë që të sigurojë se sektori publik përfiton nga ekonomia e shkallës.

Rekomandojmë Kuvendin që të sigurojë se:

- Qeveria të vazhdojë me plotësimin e bazës ligjore për të mbështetur futjen në praktikë të sistemit e-prokurimit; dhe
- Kuvendi duhet të ushtroj ndikimin e vet tek Qeveria që të sigurojë që rekomandimet tona për vitin aktual dhe ato parapraket adresohen plotësisht duke vendosur kontrolle efektive gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe duke siguruar vlerën për para.

7. SFIDAT E INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Konkluzioni i Përgjithshëm

Kapacitetet menaxhuese të OB-ve kanë tendencë rritje dhe përmirësimi të vazhdueshëm në shumë fusha të financave dhe operative. Edhe përmbushja e kërkesave ligjore për raportim financiar është evidente. Me gjithë të arriturat, institucionet buxhetore vazhdojnë të ballafaqohen me sfida nga më të ndryshmet. Buxheti i limituar në raport me nevojat reale në nivel vendi kanë pasur efektin e vet. Një analizë më e thellë e nevojave specifike të secilës OB është e nevojshme para se të përcaktohen kufijtë buxhetor. Kjo do mundësonte një shpërndarje racionale të buxhetit vendor.

Zotimet përtej fondeve në dispozicion e në disa raste mungesa profesionale në vlerësimin e nevojave buxhetore nga vet mbajtësit e buxhetit, vështirësojnë tejkalimin e barrierave aktuale. OB-të gjithashtu vazhdojnë të sfidohen dhe në menaxhimin e të hyrave, borxheve dhe të arkëtueshmeve, si dhe me raportimin e brendshëm. Ngecjet në adresimin e rekomandimeve, kanë bërë që parregullsitë të përsëriten vit pas viti. Prioritet dhe vëmendje e veçantë e menaxherëve, si nga niveli qendror ashtu edhe nga nivel lokal, duhet ti kushtohet investimeve kapitale. Aktivitetet menaxheriale duhet të kenë fokus të veçantë monitorimin dhe implementimin e projekteve me kohë dhe përmbushjen e planeve dhe objektivave. Funkcionimi i plotë i sistemit të auditimit të brendshëm do të shtonte vlerë në sigurimin e cilësisë së sistemeve të MFK-së.

7.1 HYRJE

Politikat qeverisëse të institucioneve buxhetore të nivelit qendror dhe komunal bazohen në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave të Pushtetit Lokal si dhe me legjislacionin tjetër sekondar që implementojnë këto ligje. Institucionet e nivelit lokal kanë autorizimet dhe pavarësinë që të menaxhojnë dhe shfrytëzojnë fondet nga të hyrat vetanake, grantet dhe përfitimet tjera. MF si bartës i këtyre proceseve ka përgjegjësinë të mbështesë komunat në realizimin e aktiviteteve programore të përcaktuara me planet strategjike dhe vjetore.

Përmes këtij kapitulli, do të shpalosen sfidat kryesore me të cilat po ballafaqohen institucionet shtetërore në secilin nivel organizativ.

7.2 INSTITUCIONET QENDRORE

Një ndër sfidat e Institucioneve Qendrore (IQ) vazhdon të jetë planifikimi dhe realizimi i planit vjetor buxhetor. Me gjithë avancimet e bëra në këtë drejtim, niveli i shfrytëzimit të buxhetit mbetet ende nën nivelin e planifikuar, në 89% e buxhetit final.

Kërkesat buxhetore për furnizime, shërbime dhe punë, në të shumtën e rasteve vlerësohen në mënyrë të përgjithësuar dhe atë vetëm në vlerë financiare, pa ndonjë analizë të mirëfilltë dhe prioritizim të nevojave, dhe pa ndonjë specifikim konkret rreth sasisë së furnizimeve. Karakteristikë është se OB kanë kërkesa të ngjashme buxhetore vit pas viti, sidomos për mallra e shërbime, pavarësisht plotësimit të nevojave përgjatë viteve. Vështirësitë janë evidente edhe te investimet

për projektet kapitale. Kjo mund të jetë pasojë e vonesave në aprovimin e projekteve dhe realizimit me kohë të procedurave të prokurimit. Menaxhimi dhe implementimi i projekteve afatgjata është sfida kryesore që po vazhdon të përcjellë IQ-të vit pas viti. Vështirësi tjetër e hasur gjatë këtij viti ishte edhe kategorizimi jo i duhur i shpenzimeve. Kjo ishte bazë për modifikimin e opinionit të auditimit për PVF-të e disa IQ-ve.

Mbledhja e të hyrave tatimore dhe trajtimi i borxheve të pa inkasuara mbetet sfida e vazhdueshme e ATK-së. Edhe menaxhimi i të hyrave tjera vetanake është shoqëruar me dobësi të ndryshme. Kontrollat e brendshme nuk kishin funksionuar si duhet në mbledhjen, regjistrimin, harmonizimin dhe raportimin.

IQ janë duke u përballuar edhe me sfida tjera, si në zbatimin e procedurave të rekrutimit dhe menaxhimit të personelit, por edhe me kompensimet e anëtarëve të bordeve dhe komisioneve si dhe ushtrimi i pozitave me ushtrues detyre përtej kohës së lejuar.

Në shumë organizata mungojnë politikat apo korniza ligjore për dhënien dhe monitorimin e projekteve të financuara. Përkrahja financiare pa ndonjë bazë të qartë ligjore dhe pa përzgjedhje të drejtë të përfituesve vë në dyshim përmbushjen e synimeve dhe qëllimin e dedikuar. Financimi i skemave pensionale dhe subvencionimi i programeve të natyrës shëndetësore kishte mangësitë e veta, duke mos ofruar arsyeshmëri dhe raportim të drejtë për fondet e shpenzuara. Kishte edhe vonesa në subvencionimin e fermerëve, kjo si pasojë e mos aplikimit me kohë të fermerëve, shqyrtimit të kërkesave dhe procesimit të pagesave.

Përkundër këshillave dhe rekomandimeve të auditorit, kontrollat e brendshme nuk ishin efektive në administrimin e obligimeve dhe menaxhimit të pasurisë. Investimet në vijim nuk janë trajtuar konform kërkesave ligjore. OB-të nuk kishin evidencë të plotë për pasurinë. Kjo kishte reflektim negativ edhe në raportimin financiar dhe me ndikim në opinionet e auditimit. Sa i përket obligimeve, bazuar në PVF individuale, shihet një trend i rritjes së tyre, ndërsa në anën tjetër kishte suficit buxhetor. Kjo gjendje ngarkon buxhetin e vitit pasues dhe ka efekt negativ në planet e reja buxhetore.

7.3 KOMUNAT

Rezultatet e auditimeve tregojnë se institucionet e nivelit komunal ballafaqohen me sfida të ndryshme të natyrës operative, financiare dhe organizative. Buxheti i Komunave përbëhet nga fonde të ndryshme si: granti qeveritar, të hyrat vetanake, grantet tjera, si dhe nga donacionet e jashtme dhe të brendshme. Në vitin 2014, Komunitat²⁷ kishin shpenzuar 394,271,946€ nga 450,616,014€ sa kishin në dispozicion, apo 87%²⁸ e buxhetit final.

Ashtu si në nivelin qendror, edhe institucionet e nivelit komunal nuk kanë arrit të zhvillojnë politika efektive buxhetore. Proceset e dobëta në planifikimin e nevojave, niveli i ulët i realizimit të buxhetit për investime kapitale, mungesa e projekteve adekuate, vonesat në monitorimin dhe implementim të kontratave, janë disa prej dobësive të hasura në këtë nivel të organizatave.

²⁷ Realizim më të ulët të buxhetit kishin Komuna e Prishtinës me 69%, Prizreni 84% dhe Parteshi me 82%.

²⁸ Grantet për kompetenca të zgjeruara,

Kategorizimi dhe çertifikimi i pagesave mbetet edhe më tutje mjaftë sfiduese. Të shtyrë nga kufijtë buxhetor në nivel makroekonomik, të vendosura nga MF, komunat janë detyruar që disa nevoja për mallra & shërbime dhe subvencione & transfere ti mbulojnë nga ndarjet buxhetore për investimet kapitale. Kjo imponon kërkesa dhe angazhime të vazhdueshme nga komunat për të gjetur alternativa financimi për të mbuluar shpenzimet operative brenda kufijve buxhetor.

Fushë tjetër që kërkon vëmendje ishin edhe të hyrat. Ende janë prezente mangësitë në planifikimin real të të hyrave. Duket se nuk bëhen analiza të mjaftueshme, dhe se nuk merren për bazë parametrat e viteve paraprake dhe rrethanat aktuale. Në shumë raste, objektivat/projektet që do të financoheshin nga të hyrat vetanake kanë mbetur të pa realizuara. Një faktorë tjetër kufizues është se në dy muajt e fundit të vitit, komunat nuk mund të shfrytëzojnë të hyrat e inkasuara për shkak të përfundimit të afatit për zotimin e mjeteve. Pjesë e konsiderueshme e të hyrave të pashfrytëzura barten në vitin pasues.

Sfidë tjetër mund të konsiderohet bashkëfinancimi i projekteve sipas marrëveshjeve me donatorë të ndryshëm. Meqë projektet e tilla nuk monitorohen nga komunat, ka raste që mungojnë informacionet nëse donatori është duke implementuar projektet sipas marrëveshjeve. Kjo formë e investimeve dhe menaxhimit të projekteve kërkon një sjellje dhe trajtim më ndryshe nga ana e Komunave.

Çështje tjetër që vazhdon të jetë temë e trajtimit është edhe pajtueshmëria ligjore në shpërndarjen e subvencioneve dhe transfereve, raportimi dhe monitorimi i realizimit të projekteve të bashkëfinancuara, për të siguruar se mjetet janë përdorur për qëllimin e dedikuar.

7.4 INSTITUCIONET E PAVARURA

Për vitin 2014, shpenzimet e përgjithshme të 27 institucioneve të pavarura ishin 85,026,929€, apo 86% e buxhetit final prej 99,020,539€. Vlerësuar në total, niveli i realizimit të buxhetit nuk është i kënaqshëm.

Kontrolli i brendshëm dhe aranzhimet e delegimit të detyrave dhe përgjegjësive është një nga sfidat kryesore me të cilat po përballen vit pas viti IP-të. Ndikim në këtë mund të ketë pasur numri i vogël i personelit që kanë këto institucione.

Zhvillimet aktuale tregojnë një përkushtim të menaxhmentit për të përmirësuar mangësitë e sistemit dhe adresimin e barrierave ekzistuese. Pavarësisht kësaj, kërkohen veprime shtesë për të adresuar të gjitha çështjet e dala nga auditimi.

Sfidë aktuale e IP-ve vazhdon të jetë mbulimi i aktiviteteve të tyre me shërbime të auditimit të brendshëm. Marrë parasysh strukturën organizative dhe aspektin buxhetor disa prej IP-ve nuk plotësojnë kriteret për të krijuar NjAB-në. Bazuar në këtë, aktivitetet e një numri të IP-ve nuk ishin mbuluar nga auditimi i brendshëm.

Sikurse institucionet tjera, edhe institucionet e pavaruara, vazhdojnë të sfidohen me projeksionet buxhetore, kategorizimin e shpenzimeve dhe realizimin e buxhetit. Inkasimi i të hyrave dhe menaxhimi i të arkëtueshmeve nuk ishte treguar edhe aq efikase. Rritja e bilancit të llogarive të arkëtueshme nga viti në vit është shqetësuese. Mos zbatimi i masave parandaluese rezulton me efekt financiar negativ për buxhetin e vendit.

Mbulimi i pozitive me ushtrues detyre përtej kohës së lejuar vazhdon të praktikohet. Kontrollat ishin të limituara rreth kompensimit të punëve shtesë dhe gradimet e personelit. Përkundër disa përmirësimeve, menaxhimi i pasurisë publike mbetet edhe më tej një nga fushat për përmirësim. Komunikimi formal dhe cilësia e raportimit të brendshëm të IP-ve duhet të zhvillohet tutje. Raportimi i jashtëm i lidhur me PVF-të dhe shpalosjet informatave lë vend për përmirësim.

7.5 REKOMANDIMET

Unë rekomandoj Qeverinë të siguroj:

- Një vlerësim të barrierave të cilat kanë ndikim negativ në tejkalimin e sfidave aktuale. Planet e veprimit të kenë për bazë rekomandimet e dala nga auditimet individuale;
- Se procesit të planifikimit buxhetor t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë financiare nga mbajtësit e buxhetit, duke harmonizuar nevojat reale me mundësitë aktuale buxhetore;
- Forcimin e kontroleve në certifikimin e pagesave duke siguruar zbatimin e plotë të udhëzuesve dhe kërkesave ligjore;
- Hartohen udhëzime apo rregulla për mënyrën e menaxhimit të bashkëfinancimeve me palët e jashtme; dhe
- Ngritjen e efikasitetit në inkasimin e të hyrave dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve sipas planit në mënyrë që të mbështesin projeksionet në nivel të përgjithshëm buxhetor.

Unë rekomandoj Kuvendin që:

- Të kërkojë nga Qeveria shtimin e kontroleve në ngritjen e cilësisë së raportimeve dhe kërkesave të tjera të raportimeve të jashtme;
- Të formojë njësi që kryejnë funksione dhe shërbime të përbashkëta për IP, si në fushën e financave ashtu edhe në prokurim dhe në fushën e auditimit të brendshëm, etj;

Unë rekomandoj Kuvendet Komunale që:

- Së bashku me Kryetarin e Komunës analizojnë shkaqet e përsëritjes së mangësive dhe identifikimin e barrierave me ndikim negativ në sistemin financiar dhe organizativ; dhe
- Para dorëzimit të kërkesave të reja buxhetore, të analizojnë performancën buxhetore të vitit aktual me theks të veçantë te investimet kapitale.

8. PERFORMANCA NË FUSHAT SPECIFIKE

Konkluzion i përgjithshëm

Në përgjithësi ka tentime për përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga organizatat e audituara. Megjithatë ende nuk është i mjaftueshëm monitorimi dhe mbikëqyrja mbi Bordet drejtuese nga nivelet e larta si Kuvendi. Qeveria (ose Kuvendi aty ku është e aplikueshme) nuk ka arritë të monitoroj drejtuesit/menaxhuesit e organizatave dhe të kërkoj rezultate gjatë ekzekutimit të programeve/planeve apo aktiviteteve.

Aktivitetet e organizatave të audituara në përgjithësi nuk janë sa duhet efikase dhe efektive. Kanë mungesë të strategjive, si në trafikun rrugor e në disa raste strategjitë ekzistojnë por nuk janë koordinuar me planet vjetore, si në rastin e granteve në sektorin e bujqësisë. Implementimet e programeve vjetore kanë dobësi, në përgjithësi mungon qasja drejt rezultateve dhe në shumicën e rasteve nuk i vendosin indikatorët e përformancës. Kualiteti jo i mirë i të dhënave i përcjellin shumicën e organizatave dhe nuk raportohet për arritjet apo ngecjet në rezultate, kjo dukuri u vërejt sidomos në shëndetësi, sektorin e bujqësisë dhe mirëmbajtjen e automjeteve.

Organet monitoruese dhe mbikëqyrëse nuk e luajnë rolin e tyre aktiv, për të identifikuar ngecjet e mundshme me qëllim për të marrë masa përmirësuese. Këto dobësi janë përhapur në të gjitha organizatat e audituara dhe si e tillë mjaft domethënëse.

Si përfundim ka ende mjaft për të bërë me qëllim që shpenzimi i parasë publike në programet/aktivitetet qeveritare të bëhet në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive .

8.1 HYRJE

Ne kemi kryer shtatë auditime të përformancës të cilat janë finalizuar në vitin 2015. Këto auditime kanë rëndësi të veçantë për Qeverinë, Kuvendin e Kosovës dhe entitetet e audituara pasi trajtojnë tri E-të e aktiviteteve, programeve të përdorura.

Sipas INTOSAI tri E-të definohen si në vijim:

- **Ekonomia**, minimizimin e kostos së resurseve të përdorura në një aktivitetet, duke marrë parasysh kualitetin e duhur.
- **Efikasiteti**, relacioni ndërmjet outputeve (të dalurave) në kuptim të mallrave, shërbimeve dhe rezultateve dhe resurseve të përdorura për prodhimin e tyre.
- **Efektiviteti**, shkalla e arritjes së objektivave dhe relacioni ndërmjet ndikimit të planifikuar dhe ndikimit aktual të një aktiviteti.

Fushat e trajtuara/audituar janë:

- Shëndetësia, menaxhimi i pajisjeve mjekësore;
- Bujqësia, menaxhimi i granteve në sektorin e bujqësisë niveli qendrorë dhe lokal;

- Teknologjia Informative, strategjia e qeverisjes informative në Kosovë;
- Radiotelevizioni i Kosovës, sistemi i menaxhimit dhe mbikëqyrja nga Kuvendi;
- Siguria në trafikun rrugor, aktivitetet e policisë së trafikut; si dhe
- Agjencia Kosovare e Privatizimit, auditimi i pasqyrave vjetore financiare .

Për secilën fushë/temë janë analizuar aktivitetet në kontekst të tri E-ve, apo njëres prej tyre.

Qëllimi është të japim rekomandime për përmirësimin e programeve në rastet ku identifikohen dobësi. Në mënyrë që Qeveria të jetë efektive dhe e racionalë në shpenzimin e mjeteve si dhe të arrihen rezultatet e dëshiruara.

8.2 SHËNDETËSIA – MENAXHIMI I PAJISJEVE MJEKËSORE

Institucionet shëndetësore publike (IShP) obligohen të ofrojnë shërbime adekuate qytetarëve/taksapaguesve. Ato posedojnë numër të konsiderueshëm të Pajisjeve Mjekësore, mirëmbajtja e tyre (për vitet 2012, 2013 dhe 2014) ka kushtuar më shumë se 780,000€. Ne kemi vlerësuar mënyrën se si menaxhohen pajisjet mjekësore, rasti Tomografia e Kompjuterizuar, në QKUK dhe tre Spitale në Mitrovicë, Prizren dhe Pejë.

Ministria e Shëndetësisë nuk iu ka ofruar spitaleve udhëzues adekuat për mënyrat e përdorimit dhe monitorimin e menaxhimit të pajisjeve mjekësore. Spitalet nuk kanë marrë iniciativë të mjaftueshme për një organizim adekuat të monitorimit mbi mënyrën e menaxhimit të pajisjeve mjekësore nga stafi përgjegjës. Librat e ndërrimeve nuk janë mbajtur si duhet duke zvogëluar mundësinë për të pasur informata të nevojshme dhe të mjaftueshme për gjendjen e pajisjeve dhe trajtimin e pacientëve.

Përkundër servisimeve, shumicën e kohës pajisjet e Tomografisë së Kompjuterizuar janë jashtë funksionit. Kjo për shkak të menaxhimit të dobët dhe jo efektiv në servisim dhe përdorim të pajisjeve. Si pasojë pacientët janë detyruar të drejtohen në spitale private ku çmimi për skenim të pjesërisht është 200€ ndërsa për skenim të plotë arrin deri në 1000€ , dhe kjo paguhet nga pacientët.

8.3 BUJQËSIA

8.3.1 MENAXHIMI I GRANTEVE NGA MINISTRIA E BUJQËSISË

Qeveria i jep mbështetje sektorit të bujqësisë me qëllim të zhvillimit të sektorit. Në vitin 2013 nga Buxheti i Kosovës janë dhënë grante për bujqësi 14.8mil€, në 2014 11.2mil€, dhe 20mil€, të planifikuara për vitin 2015.

Vendosja e sistemit për menaxhimin e granteve është orientuar në parimet e BE-së për zhvillim rural por ende ka dobësi dhe duhet shumë për të bërë. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Komiteti Monitorues i granteve nuk janë plotësisht funksionalë. Ende nuk ka raporte cilësore për

rezultatet e arritura në bujqësi përmes granteve. Pagesat për fermerë janë vonuar shumë dhe nuk ka sistem të mirë për trajtimin e ankesave të bëra nga fermerët.

Po ashtu ende nuk janë themeluar/vendosur Komiteti Ndërministror për zhvillim rural në vend dhe Zyrtari Kombëtar Autorizues. Ndërsa Programi strategjik për bujqësi 2014-2020 që është në zbatim, ende nuk është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Strukturat e vendosura për menaxhimin e granteve nuk janë plotësisht funksionale ndërsa disa nuk janë themeluar ende. Kjo gjendje nuk është në korrelacion me rritjen e vazhdueshme të buxhetit për këtë sektor, nuk siguron rezultate dhe shfrytëzim efikas të mjeteve.

8.3.2 GRANTET KOMUNALE NË BUJQËSI – KOMUNA E PRIZRENIT

Rajoni i Prizrenit është ndër tri rajonet me sipërfaqe më të madhe të tokës dhe ekonomive bujqësore, që ka rendësi në ofrimin e mundësive të punësimit.

Në vitin 2014 komuna ka realizuar grante në vlerë 342,543€, por objektivat në planin operativ (2014) nuk janë të qarta dhe mungon ndërlidhja me planet strategjike. Indikatorët kyç të performancës nuk janë identifikuar dhe informimi i fermerëve rreth granteve ishte jo cilësor. Sistemi i monitorimit të granteve nuk është funksional dhe nuk është bërë analizë për rezultatet, efektet dhe ndikimin e prodhuar nga programi granteve.

Komuna ka mbështet sektorin e bujqësisë pa pasur objektiva dhe strategji të qartë. Kjo gjendje mund të shpije deri tek shpenzimi i parasë në mënyrë jo efikase dhe jo efektive.

8.4 TEKNOLOGJIA INFORMATIVE (TI)

Inicijativa e Qeverisjës elektronike (QE) ka për synim përmirësimin e shërbimeve për qytetarët, forcimin e llogaridhënies, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e efikasitetit të qeverisë.

TI-ja krijon mundësi për të ofruar shërbime/informata publike, ku qasja është e shpejtë. Për një zhvillim më të shpejtë ekonomik në Republikën e Kosovës, është i domosdoshëm krijimi/zbatimi i strategjisë me shërbime elektronike për qytetarët e bizneset në Kosovë.

Ministria e Administratës Publike ka mision krijimin e një administrate moderne publike dhe ka themeluar Agjencinë për Shoqërinë e Informacionit-ASHI. Auditimi ynë ka identifikuar sfidat në këtë fushë. Qasja në shërbimet qeveritare nëpërmjet internetit janë të kufizuara, ka mungesë të qeverisjes e përgjegjësisë qendrore. Strategjia e QE nuk është e koordinuar, monitoruar dhe vlerësuar, ka kuptueshmëri të pamjaftueshme për sigurinë e sistemeve qendrore dhe ka mungesë koordinimi të përbashkët, Ministritë kanë ndjekur rrugë të ndryshme në investimet e qeverisjes elektronike.

Nga perspektiva e qytetarëve, qeverisja elektronike ende nuk është efektive. Përfitimet e pritshme ekonomike dhe sociale të paraqitura në strategji janë ende të kufizuara.

8.5 SISTEMI I MENAXHIMIT TË RADIOTELEVIZIONIT TË KOSOVËS

RTK është transmetuesi i vetëm publik në vend dhe financohet nga Buxheti i Kosovës.

RTK është duke tentuar të mbaj hapin me zhvillimet teknologjike që kanë për qëllim mbajtjen e konkurrentueshmërisë në sektorin e medias në Kosovë. Megjithatë ndër sfidat që e përcjellin këtë medium janë menaxhimi i operimeve, adresimi i dobët i rreziqeve nga Bordi dhe mbikëqyrja e pamjaftueshme nga Kuvendi.

Po ashtu, kemi hasur në raste kur politika të caktuara, si ajo e rritjes së shërbimeve të ofruara, punësimi dhe ndikimi financiar përcjellës, nuk korrespondojnë plotësisht me shfrytëzimin racional të resurseve. Në një ambient të varshmërisë financiare, planifikimi joadekuat dhe shfrytëzimi i resurseve mund t'i rrezikojnë operimet afatgjata të transmetuesit.

8.6 SIGURIA NË TRAFIKUN RRUGOR

Numri i aksidenteve në vitin 2013 ishte rreth 20,000 dhe ka trend të rritjes. Policia e trafikut është autoriteti i vetëm publik që kontrollon dhe mbikëqyrë sjelljet e pjesëmarrësve në trafik.

Policia e trafikut duhet të zhvilloj më tutjepërdorimin burimeve të informatave në mënyrë efektive. Kontrollat në trafik janë pjesërisht të bazuara në rrezikshmëri, dhe nuk janë efektive në aspektin e vendeve, kohës së kontrolleve dhe numrit të policëve. Nuk kryhen veprime parandaluese njëkohësisht kontrollimi i standardeve teknike të automjeteve si dhe ndëshkimet jo gjithherë aplikohen dhe menaxhohen siç duhet ndaj kundërvajtësve.

Përvoja në trafikun rrugor na tregon se numri i aksidenteve në trafik dhe pasojat e tyre mund të zvogëlohen. Andaj ka ende për ta bërë që policia e trafikut të jetë efektive.

8.7 AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

AKP është përgjegjës për implementimin e programit të privatizimit në Kosovë. Shumica e çështjeve të adresuara në auditimet e mëhershme kanë mbetur të njëjta edhe në këtë vit.

AKP-së i mungon Bordi ndërsa struktura menaxhuese është e pakompletuar, si rrjedhojë nuk merren vendime dhe ka raste të vendimmarrjes të pa dokumentuar qartë dhe pa analiza ekonomike.

Dobësi tjera domethënëse janë vërejtur në pagesën për shërbime të jashtme për autoritetin e likuidimit. Fondet e NSH-ve në likuidim janë përdor për shërbime administrative të AKP-së dhe ka kontrolle të dobëta në shpërndarjen e 20%-shit. Dinamika e privatizimit është e ulët. Po ashtu mangësi ka në Mallra dhe Shërbime, Llogaritë e arkëtueshme dhe menaxhimin e Pagave dhe Mëditjeve.

8.8 REKOMANDIMET

Rekomandojmë Qeverinë që:

- Ministria e Shëndetësisë, të siguroj udhëzues për menaxhim të pajisjeve dhe të siguroj funksionimin e duhur të Tomografive të Kompjuterizuara dhe të gjitha pajisjeve tjera.
- Të formoj komisionet për mbikëqyrje të pajisjeve dhe të përcjellën listat e pacientëve e të raportohen;
- Ministria e Bujqësisë, të siguroj funksionalizimin e plotë të AZHB-së dhe KM-së, implementim e raportim cilësor të zbatimit të Programit dhe proces të pavarur për trajtimin e ankesave të fermerëve;
- Të themeloj Komitetin Ndërminstor për bujqësi dhe zhvillim rural dhe Zyrtarin Kombëtar Autorizues;
- Ministri i MAP, ta funksionalizoj ASHI-në, ta rrit koherencën midis projekteve dhe ti jepet prioritet zhvillimit/krijimit të kushteve për qeverisje elektronike;
- ASHI-ja, t'u ofroj qytetarëve mundësi të barabarta të qeverisjes elektronike, Strategjia QE të monitorohet, vlerësohet apo rishikohet në mënyrë periodike;
- Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës ta bëjë efektiv sistemin e informimit, me bazë gjithëpërfshirëse të të dhënave, policia e trafikut të përqendrohet në parandalimin e aksidenteve dhe në sjelljet tjera të ngasësve, përveçse të tejkalimi i shpejtësisë si dhe të përmirësohet sistemi i ndëshkimeve dhe të aplikohet sistemi "pikëve negative".

Rekomandojmë Kuvendin që:

- Të rishikoj dhe të miratoj Programin për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2020;
- Bordi i drejtorëve i RTK-së, të sigurojë zbatim me kohë të vendimeve, rekomandimeve të Kuvendit si dhe të rrisë llogaridhënien e Drejtorit të Përgjithshëm ndaj Bordit si dhe të reduktoj rreziqet me kosto të lartë;
- Në RTK të ushtroj mbikëqyrje efektive brenda mandatit, pa cenuar pavarësinë editoriale dhe të themeloj komision ad hoc për propozimin e zgjidhjes së përhershme për RTK-në, si digjitalizimi, financimi dhe akomodimi;
- Të bëjë rekrutimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së i cili me urgjencë do të plotësoj pozitën e lira në menaxhmentin e lartë; si dhe
- Menaxhmenti i AKP të siguroj efektivitet në menaxhimin financiar dhe operativ, proces të rregullt rekrutimit e menaxhimit të personelit dhe menaxhim të mirë të llogarive të arkëtueshme.

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që:

- Komuna e Prizrenit, në plane të bëjë objektiva SMART, në përputhje me objektivat strategjike dhe metoda efektive të informimit të fermerëve;
- Të monitorohen dhe vlerësohen rezultatet nga grantet dhe të raportohet për progresin e arritjes së objektivave.

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për "Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit".

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin "Theksim i Çështjes" ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

SHTOJCA II: OPINIONET E AUDITIMIT DHE MANGËSITË MENAXHERIALE

Tabela 1. Llojet e opinioneve sipas Entiteteve të audituara

Entitetet e Audituar/ Opinionet e Auditimit	Opinion i pa modifikuar	Opinion i pa modifikuar me Theksim Çështje	Opinion i Kualifikuar	Opinion i Kualifikuar me Theksim Çështje	Mohim i Opinionit
Institucionet Shtetërore ²⁹	11	10	-	3	-
Komunat	1	17	2	14	4
Agjencitë e Pavarura	22	4	1	1	-
Entitetet jashtë BK-së ³⁰	2	-	-	-	-
Gjithsej	36	31	3	18	4

²⁹ Përfshihen 19 Ministri, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit të Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës.

³⁰ Përfshihet TAMAD, dhe Fondi i Bashkuar për Sektorin e Arsimit.

Tabela 2: Opinonet e Auditimit dhe mangësitë menaxheriale për Institucionet Shtetërore

2.1 Opinonet e pamodifikuar		
Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Mangësitë kryesore menaxheriale
Ministria e Punëve të Brendshme	105.90	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së; Niveli i ulët i ekzekutimit të buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale; Mangësi në ekzekutimin e shpenzimeve përmes procesit të prokurimit; Pagesat për të punësuarit me kontrata për shërbime të veçanta nga kategoria mallra dhe shërbime; Numri i madh i pozitive të cilat mbulohen me ushtrues detyre.
Ministria e Forcave të Sigurisë së Kosovës	40.50	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së; Menaxhim i dobët i projekteve kapitale; Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore.
Ministria e Financave	31.75	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së ; Mangësi në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit; Mangësi menaxhimi në planifikim dhe ekzekutim të buxhetit.
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	30.40	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së dhe Kontrolli i cilësisë mbi përpilimin e PVF-ve është i dobët; Keq klasifikimi i shpenzimeve; Kërkesat për qeverisje siç janë menaxhimi i rrezikut, nuk po implementohet plotësisht; Përmirësim i kontrolleve në prokurim, në procesin e pagesave dhe në menaxhimin e pasurive; Puna e NJAB-së nuk është në nivelin e duhur dhe si rezultat ka dështuar në mbështetjen e menaxhimentit në fushat kyçe të aktivitetit.
Ministria e Administratës Publike	23.79	PVF-të kanë përfshirë numër të pa saktësive dhe gabimeve; Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së; Kontrollë jo të mira në fushën e prokurimit dhe sektorin pagesave ;Rritje e madhe e vlerës së detyrimeve të papaguara ndaj Operatorëve Ekonomik krahasuar me vitin e kaluar.
Ministria e Drejtësisë	19.02	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së; Ekzekutimi i ulët i buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale; Pagesa për situacionet e projekteve kapitale të cilat nuk janë regjistruar në regjistrin e pasurisë; Raportet mujore të obligimeve nuk ishin të besueshme.
Administrata Tatimore e Kosovës	8.39	Kontrollet e dobëta për plotësinë dhe saktësinë e rimbursimeve kanë rezultuar me mangësi dhe diferenca në këtë komponentë; Niveli i kontrolleve jo efektiv në të gjitha rastet në fushën e prokurimit, financave dhe menaxhimin e burimeve njerëzore; Pavarësisht progresit të treguar në arkëtimin e të arkëtueshmeve, edhe më tej, trajtimi i borxheve të vjetra dhe trendi i rritjes së borxheve të reja mbetet sfidë për ATK-në.
Kuvendi i Kosovës	8.01	Niveli i ulët i ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale; Mangësi në menaxhimin e procedurave të prokurimit dhe të kontratave; Mangësi në menaxhimin e pasurisë.
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	5.18	PVF-të kanë përfshirë numër të pa saktësive dhe gabimeve; Ekzekutimi i buxhetit gjatë vitit 2014 nuk ishte në nivelin e pritur; Buxheti për investime kapitale ishte shpenzuar vetëm 75%; Mangësi në procesin e rekrutimit të stafit dhe procedurat për avansim të zyrtarëve; Mangësi në menaxhimin e pasurisë.
Ministria e Diasporës	2.96	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së; Mangësi në menaxhimin e pagesave dhe prokurim, pagesa për aktivitete të palëve të jashtme; dhe në procesin e dhënies së subvencioneve.
Zyra e Presidentit	1.75	Mangësi në proceset e prokurimit; Mos kryerja e auditimit të brendshëm sipas planit vjetor.

2.2 Opinionet e Pa Modifikuara me Theksim të Çështjes

Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Arsyeja për Theksim të Çështjes	Mangësitë kryesore menaxheriale
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	285.73	Dhënia e subvencioneve nga Ministria pa bazë të qartë ligjore; dhe , pagesat nga subvencionet dhe transferet e bërë për mallra dhe shërbime.	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së; Raportimi menaxherial dhe financiar brenda Ministrisë ishte i dobët; Planifikimi i buxhetit po ashtu mund të përmirësohet; Mangësi në menaxhimin e subvencioneve (aplikimi i kriterëve të përzgjedhjes); prokurimit dhe Paga e mëditje; Mos kryerja e auditimit të brendshëm sipas planit vjetor rritja e efektivitetit të Komitetit të Auditimit.
Ministria e Shëndetësisë	120.54	Informatat e shpalosura mbi pasuritë fikse dhe stoqet nuk ishin plotësisht të sakta dhe të besueshme	Mangësi në menaxhimin e subvencionimit të pacientëve nga programi TMJIPSH ³¹ ; dhe në shpenzime për paga; Mangësi në menaxhimin e pasurive fikse si dhe ato të stokut farmaceutik si dhe shpalosja e tyre në PVF; Mangësi në sistemin e Auditimit të Brendshëm .
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	53.71	Informatat e shpalosura mbi pasuritë fikse jo plotësisht të besueshme.	Mangësi në menaxhimin e regjistrimit të pasurive; Mangësi në ekzekutimin e buxhetit sidomos tek mjetet nga donacionet; Mangësi në menaxhimin e shpenzimeve përmes prokurimit dhe shpenzimeve jo përmes prokurimit, pagave dhe subvencionet; Trendi rritjes së obligimeve të papaguara; Fuqizimi i funksionit të auditimit të brendshëm dhe funksionalizimi i Komitetit të auditimit.
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	47.93	Informatat e shpalosura mbi pasuritë nuk ishin të plota dhe të sakta; rritja e obligimeve të papaguara, që ndërlihen kryesisht me shpronësimet.	Pasuritë nën pronësi të MMPH-së (AKK) nuk janë regjistruar plotësisht. Po ashtu janë evidentuar vonesat në inventarizimin e pasurisë; Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së ;Mangësi në raportim/harmonizim të të hyrave; Rritja e llogarive të arkëtueshme; Mangësi në menaxhimin e prokurimit; kompensimet për punë jashtë orarit dhe obligimet e pa paguara.

³¹ Trajtimet Mjekësore Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore

Ministria e Bujqësisë, Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural	28.27	Informatat e shpalosura mbi pasuritë jo të plota dhe të sakta; Rritja e obligimeve të papaguara, që ndërlidhen kryesisht me vonesat në kryerjen e pagesave për subvencione dhe transfere,	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së; Pasuritë në pronësi të ministrisë nuk janë regjistruar në plotësi; Mangësi në ekzekutimin e buxhetit; në kryerjen e pagesave për subvencione; në zbatimin e kontratave .
Zyra e Kryeministrit	12.05	Mungesa e raportimit për mënyrën e shpenzimit të subvencioneve	Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së; Mangësi në raportimin e subvencioneve; Mangësi në procesin e pagesave dhe prokurim; Informata jo të plota në regjistrat e pasurive; Në AUV, nuk kishte depoist i cili do të kryente pranimin dhe regjistrimin në e-pasuri.
Doganat	9.89	Evidencat e mbajtura dhe informatat e prezantuara tek shpalosjet e llogarive të arkëtueshme në PVF nuk ishin të plota.	Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme Shtim i kontrolleve në menaxhimin e shpenzimeve; Kërkohet avancim i mëtejme në menaxhimin e të hyrave.
Ministria për Kthim dhe Komunitete	7.15	Investimet e bëra për komunat dhe komunitetin nuk ishin regjistruar si pasuri e MKK-së si dhe nuk ishte bartur te përfituesi si pasuri financiare. Mos shpalosje e detyrimet kontingjente në pasqyra financiare.	Mos plotësimi i formës së vetëvlerësimit, kërkesë e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; Planifikim jo i mirë i buxhetit për kategorinë e investimeve kapitale; Evidenca jo të plota lidhur me pasurinë jo financiare; Mos shpalosje e detyrime kontingjente për tri vitet e fundit.
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	5.78	Mos prezantimi i plotë i pasurive kapitale në shënimet shpjeguese në PVF.	Kontrolle të pamjaftueshme lidhur me plotësinë e pasurisë; Mangësi në menaxhimin e shpenzimeve përfshirë pagat dhe mëditjet; Mungesa e veprimeve konkrete nga menaxhmenti për adresimin e sfidave.
Ministria e Integritimit Evropiane	1.68	Në informatat e shpalosura pasuria jokapitale është mbivlerësuar.	Planifikimi i buxhetit jo sipas nevojave reale; Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së; Mangësi në menaxhimin dhe kompensimin e personelit; Subvencioni i OJQ-ve për projektet jo sipas kornizën ligjore të aprovuar nga vet Ministria.

2.3 Opinonet e Kualifikuara me Theksim të Çështjes

Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Arsyeja për kualifikimi e opinionit	Mangësitë kryesore menaxheriale
Ministria e Infrastrukturës	199.51	Keq klasifikimi të shpenzimeve. Qasje jo sistematike e Ministrisë për ta konfirmuar një gjendje fillestare të pasurisë së trashëguar si dhe projektet kapitale që nuk ishin evidentuar si investime në vijim (por si pasuri kapitale) në SIMFK ishin zhvlerësuar pa përfunduar i tërë projekti	Pasuritë e trashëguara nuk janë vlerësuar në mënyrë të saktë gjer sa shpenzimet kapitale në vijim janë kapitalizuar; Paqartësi mes shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrugëve që duhet të kapitalizohen dhe të atyre që janë të natyrës së përgjithshme; Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së; Planifikimi jo real i të hyrave; Mangësi në procedurat e prokurimit ; Nën deklaram të obligimeve; Mangësi në menaxhimin e borxheve.
Ministria e Punëve të Jashtme	21.00	Keq klasifikimi i shpenzimeve, mos mbyllja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime dhe mos evidencimi i dy projekteve në regjistrin kontabël.	Shpenzimet e paaprovuara të MDK-ve të viteve të kaluara edhe në këtë vit nuk ishin regjistruar; Cilësia e kontrollit mbi përgatitjen e PVF-ve ishte jo e mirë duke rezultuar me keq klasifikim material; Implementimi i rekomandimeve ishte i ulët; Mangësitë e vitit të kaluar janë identifikuar edhe gjatë këtij viti si: Pozitat me U.D, ndarja e tenderëve, emërimet në MDK dhe menaxhimi i pasurisë; Aplikimi i kursit të ngrirë të këmbimit nga MDK në Zvicër i parashikuar nga viti 2011.
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	19.66	Keq klasifikim të shpenzimeve ndërmjet kategorive ekonomike Informatat në lidhje me pasuritë fikse janë materialisht të nënvlerësuar dhe të pasakta, dhe ; nuk ishin shpalosur në PVF projektet e subvencionuara /përkrahura.	Mangësi në hartimin e PVF; Mangësi në raportim mes departamenteve, Ministrisë dhe Institucioneve vartëse; Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së ; Ekzekutim i ulët i buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale; Mangësi në procesimin e shpenzimeve përmes prokurimit, pagat, subvencionet dhe Investimet kapitale ;Sistemi i Auditimit të Brendshëm nuk kishte kontribuar tek menaxhmenti siç pritej.

Tabela 3 Opinione e Auditimit dhe mangësitë menaxheriale për Komuna

3.1 Opinonet e pamodifikuar		
Komunat	Buxheti (në mil.€)	Mangësitë kryesore menaxheriale
Hanit i Elezit	2.05	Mos zbatimi i plotë rekomandimeve të AP-së; Mangësi në qeverisjen e mirë; Nivel i ulët i ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale; Mangësi në procesin e planifikimit dhe arkëtimin e të hyrave; Mangësi në planifikimin dhe realizimin e projekteve përmes prokurimit, Llogarive të arkëtueshme; Mos themelimi i NjAB-it.

3.2 Opinioni i Pamodifikuar me theksim të Çështjes			
Komunat	Buxheti (në mil.€)	Arsyeja për theksim të Çështjes	Mangësitë kryesore menaxheriale
Prishtinë	82.02	Mos regjistrimi i pasurive të blera gjatë vitit dhe të trashëguara në SIMFK; Keq klasifikimi i shpenzimeve nga kategoria e investimeve kapitale në mallra dhe shërbime dhe subvencione.	Regjistri i pasurive jo i plotë; Pa saktësi dhe gabime në përgatitjen e draft PVF-ve; Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve të AP-së; Mangësi në qeverisjen e mirë; Nivel i ulët i ekzekutimit të buxhetit; Menaxhimi dhe monitorimi i dobët i të hyrave; Mangësi në menaxhimin e shpenzimeve përmes prokurimit, dhe llogarive të arkëtueshme; Ekzekutimi i pagesave jo në përputhje me rregullat e thesarit; Shfrytëzim i pa mjaftueshëm i kontributit të NJAB-it.
